



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-30792/22
Kaçanik, 16.11.2022

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 22 nëntor 2022 (e Martë), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e X (dhjetë) të Rregullt të KPF-s të datës 22.11.2022, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026;
3. Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022;
5. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;
6. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 01274-3 dhe 01274-4 në ZK Kaçanik, për këmbim me pronën komunale 01274-1 në ZK Kaçanik.
7. Propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pjesëve të PK 00431-3 dhe 00431-4 në ZK Duraj, për këmbim me pronën komunale 00430-1 ZK Duraj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-27687/22
Kaçanik, 20.10.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX (nëntë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 20 tetor 2022. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi. Në mbledhje mungoj me arsye Agim Mani.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Zahir Doda-DA, ndërkaq nga zyrtarët: Vedat Dema- Koordinator i ZDNJ dhe Mavije Murseli- asistente e Kryesuesit të KK.

Mbledhjen e monitoroj nga OSBE- Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, me arsye mungon Agim Mani, -me ka njoftuar se është jashtë shtetit. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IX (nëntë) të rregullt të KPF-a për vitin 2022, data me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022;
3. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;
4. Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025;
5. Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023;
6. Informatë për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022;
7. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë;
8. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022;
9. Propozim Vendimi për transferim dhe rialokim të mjeteve buxhetore.

Para se me hapur diskutimin, Kryesuesi i Kuvendit kërkoj nga KPF që në rend pune të hynë edhe pika 9, duke i dhënë arsyet se ka lindur nevoja e rialokimit dhe transferit të mjeteve për shpenzim sa me të madh të buxhetit. Kjo çështje e vonuar për KPF, për KK nuk është e vonë me dërguar këtë material. Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Për këtë herë pajtohem edhe pse nuk ka kuptim me marrë kaq vonë këtë material, ndërkaq për hera tjera me na ardhur materiali i veçantë për KPF dhe i veçantë për mbledhje të KK.

Kryesuesi i Kuvendit: E potencova se kjo është çështje e vonuar, por duke pa rëndësinë e buxhetit, nevojës për shpenzim sa më të madh të buxhetit, është pa e nevojshme me proceduar edhe këtë pikë. Rendin e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 9 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Kryesuesi i Kuvendit: Vërejtje në procesverbal nuk pati, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KPF e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së VIII (tetë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 26.09.2022/ Lënda: 01Nr. 60/01-25444/22.

2. Raporti financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Raportet financiare trajtohen në KPF dhe KK në çdo tre muaj. Edhe pse janë trajtuar në vitin 2021, MAPL në Grantin e performancës na kishte vlerësuar me 0 pikë këtë indikator. Është mirë me shprehur këtë shqetësim në MAPL pasi kishte ende afat të ankesave.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Raportet financiare janë trajtuar, por çështja është së Raporti tremujor financiar janar-mars 2021 nuk është trajtuar në muajin prill, por në muajin maj. Kjo është arsyeja që nuk e vlerësojnë me pikë në Grantin e performancës.

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Në raportin financiar pasqyrohet buxheti i aprovuar dhe buxheti aktual. Buxheti aktual është 9,959, 638.88€ Buxheti i shpenzuar në total është 5,081,600.27€ apo 59%. Në raport me vitin e kaluar, është për 6.21 % me pak i shpenzuar të Granti i Arsimit dhe të Granti i Shëndetësisë. Të HVK janë 7.50%, ka munguar inkasimi në muajin shtator që ishte grevë për 18,000 € me pak. Sipas kategorive ekonomike janë shpenzuar, Paga; 66%, Mallra dhe shërbime 57%, Shërbime komunale 33%, Subvencione dhe transfere, 51%, Investime kapitale 25%, ku mjetet janë shpenzuar kryesisht nga granti qeveritar, ndërkaq me pak të shpenzuara janë mjetet nga të HVK. Shpenzuesi me i madh është drejtoria e Arsimit me 53%, Shëndetësia dhe Shërbimet Sociale 14%, 33% të gjitha shërbimet tjera të administratës. Të Mallrat dhe Shërbimet në mënyrë analitike e tregojmë secili mjet ku është shpenzuar, nuk ka shpenzime pa vend, p.sh. dreka zyrtare

583€. Shpenzimet e gjykatave për vonesa na janë shqiptuar disa gjoba. Janë të specifikuara shpenzimet e Subvencioneve dhe Transfereve, shuma 172,646.46€. Drejtori dha edhe shpjegime tjera sesi është shpenzuar buxheti, në secilin sektor, ndërkaq shtoj se lufta në Ukrainë ka ndikuar në inflacion- ngritjen e çmimeve. Kompanitë edhe pse i kanë nënshkruar kontratat, kërkojnë me ua ndryshuar çmimet për shkak të inflacionit.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka kush që donë me marrë fjalën:

znj. Kadrije Lika-Troni: Pyetje për drejtorin: Të shpenzimet kapitale, përqindja e realizuar 24% është shumë e vogël në këtë kategori buxhetore. Cila është arsyeja që nuk janë shpenzuar me tepër mjete?

z. Bahri Selimi: Shikuar historikisht projektet, lidhen kontratat, anulohen, çështja e vonimit të pagesave, krejt këto shkojnë në dëme të operatorit ekonomik. Herëve tjera, realizimi ka qenë me i lartë, tani pagesat janë këto që janë, ka pasur ngecje të organi shqyrtues i prokurimit publik. Sipas ligjit, ofertuesi me i lirë e merr kontratën, ndërkaq është e drejta e ankesës për ofertuesit me çmime me të larta. Ne si komunë pësojmë sepse ka procedura shqyrtimi i ankesave dhe merr kohë. Tani deri me këtë datë 20 shtator është ngritur përqindja e realizimit të projekteve. Më shumë informata mund të japin drejtorët e DUKMM dhe DSHPE, mirëpo të njëjtit janë në terren. Nëse iu intereson ndonjë projekt i specifikuar, mund të jap sqarime, ndërkaq në përgjithësi të dhënat i dinë me mirë dy drejtorët, se janë me kompetentë. Lufta në Ukrainë, inflacioni, ngritja e çmimeve, firmat i kanë kontestuar çmimet dhe kanë kërkuar me ua ngritur pagesat, por Zyra e prokurimit nuk ka të drejtë me i lëvizur çmimet, ndërkaq operatorët nuk kanë faj se çmimet janë ngritur. Pritet miratimi i një rregulloreje e qeverisë lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit: Rregulloren e ka hartuar qeveria, pritët miratimi në KK. Kuvendi i Kosovës e miraton Bordin e OSHP, se ka pasur mungesë të anëtarëve të bordit deri vonë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kush bënë pjesë në organin shqyrtues të OSHP ?

Kryesuesi i Kuvendit: Kuvendi i Kosovës e miraton Bordin e OSHP. Ka pasur mungesë të bordit të OSHP për shkak se bordi nuk ka qenë i kompletuar me funksionuar, ndërkaq tani para 1 muaji është formuar bordi i OSHP.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Po mundohem me dhënë sqarime konkrete znj. Kadrije. Për momentin e kemi tenderuar rrugën: Teneq-Stagovë, me çmim me të lirë, është ankuar operatori i dytë. Ankesa i shkon zyrës së prokurimit në afatin 10 ditor. Zyra e prokurimit ia kthen përgjigjen në bazë të dhënave që i ka, ndërkaq operatori ka të drejtë me u ankuar në OSHP. Në OSHP është eksperti që e vlerëson, ai e ka dhënë mendimin brenda 6 javësh, mirëpo duhet me dhënë mendim edhe bordi i OSHP. Bordi i ka dy mënyra: e thërret shefin e prokurimit me argumentuar, ose e kthen në favor të mendimit të ekspertit, se 90% e rasteve kthehen në mendimin e ekspertit, por për shkak se nuk ka funksionuar ka kohë bordi i OSHP, ata thonë se kemi shumë lëndë, edhe pse kontrata është në favor tonë, kemi mbetur peng që 8 javë, se pa e marrë përgjigjen nuk mund të lidhet kontrata. Kështu janë bërë 3 muaj e nuk kemi pasur mundësi me lidhur kontratë, kjo po ndodhë tek të gjithë. Në vitin e kaluar për shkak të mosfunksionimit të OSHP janë kthyer shumë mjete nga të gjitha organizatat buxhetore. Sivjet është duke funksionuar bordi, por me kapacitete të kufizuara.

znj. Ardita Rrahmani: Për derisa nuk i kemi prezentë drejtorët kompetent me folur për projekte, do të ishte me mirë me debatuar në KK këtë çështje me prezencë të drejtorëve të drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit: Për çështjen e projekteve, është kryetari prezentë dhe mund të jap sqarime të nevojshme për projekte konkrete.

znj. Ardita Rrahmani: Të Projektet e zhvillimit të turizmit, janë paraparë 35.000 €, ndoshta është filluar ndonjë projekt, por nuk ka të dhëna të mjeteve të shpenzuara në këtë sektor.

Kryetari i Komunës: Ne kemi qenë të zëvendësministri i infrastrukturës me drejtorin Ramadush, në muajin qershor. Është pritur miratimi i rregullores me iu dhënë mundësinë kompanive me ua shtuar mjetet se janë ngritur çmimet. Ne e kemi rastin e Çarshisë së Vjetër, janë grant diku 140.000 €, vitin e kaluar është nënshkruar kontrata, ligji ia mundëson kompanisë mos me filluar punën se janë ngritur çmimet, sepse kompania shkon në humbje. Unë nuk po mundem me bindur kompaninë me filluar me punuar pa u miratuar rregullorja e OSHP dhe nuk kemi mekanizëm me detyruar kompaninë me punuar. Ky problem është nivel vendi, shpresoj të tejkalojmë. Kryesuesi tha se u miratua rregullorja në qeveri, pritet të miratohet në KK, dhe besoj se do të merr miratimin, në të kundërtën ne nuk mund të tejkalojmë këtë problem që ka ndodhur si rezultat i ndryshimit të çmimeve të tregut-inflacionit.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky raport financiar t'i shkoj KK. Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Diskutoj

Raporti Financiar për periudhën: Janar-Shtator 2022 dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për diskutim.

3. Propozim Vendimi caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, e keni parë se normat tatimore janë të njëjta me ato të vitit të kaluar, nën këto norma nuk mundemi me shkuar se ky është limit i fundit. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia adresuar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023. Ky propozim Vendim i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, zyrtari që e ka hartuar planin e veprimit është këtu. E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: Unë e kam ngritur këtë temë në seanca të KK dhe të kryetari, me formuar një kod buxhetor për një punësim të një femre në Zyrën për Barazi Gjinore (ZBGJ). Dhuna në familje është me e theksuar të gjinia femërore dhe kjo zyre funksionon më mirë në terren kur ka përfaqësim femra, sepse rastet me lehtë i komunikohen një zyrtari femër. Unë në vazhdimësi

do të ngriti këtë çështje, pavarësisht se ju ndoshta mendoni se nuk janë krijuar ende kushtet edhe për një punësim në këtë zyre, mendoj se është nevojshme me qenë një femër në këtë zyre.

Kryetari i Komunës: Kjo është një rregullore që jemi të obliguar me pasur në nivel vendi. Sa për trajtimin e tyre është QPS dhe është një femër aty e punësuar. Për shkak të numrit të kufizuar, se kemi rate si të auditimi, duhet me i pasur 3 zyrtarë, por komunat e vogla e kanë problem me ngritur numrin e punëtorëve, jemi detyruar punëtorëve me iu dhënë edhe punë shtesë me i mbuluar pozitat e paplotësuar. Ne me shikuar me rregulla, në arsim janë 80 punëtorë me tepër, kështu për kohën e kemi problem me marrë edhe një punëtorë në atë zyrë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Mendoj se edhe në zhvillim të aktiviteteve që parashihen, qasja e një femre, sidomos në zonat rurale, shumë me lirshëm kishin me u shprehur femrat për problemet e tyre, sesa që kishin me ardhur vet me raportuar rastet. E dyta, e kam potencuar çështjen e një strehimore për gratë dhe fëmijët që përjetojnë dhunë, së është vështirë dhe larg me u trajtuar në Ferizaj, ku përveç dhunës që përjetojnë, po duhet ndryshuar komplet edhe shoqërinë dhe kjo ndikon shumë edhe në psikikën e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Organi që i trajton këto raste, do të ishte niveli qendror, se këto vende nuk mund të jenë edhe shumë publike për shkak të natyrës dhe problematikës që trajtohet. U përmend me qenë një femër në ZBGJ se funksionon më mirë kjo zyre. Ne duhet pasur parasysh faktin se kjo zyre zhvillon politika, bënë plane për trajtimin e barazisë gjinore, ndërsa Qendra për Punë Sociale (QPS) dhe Policia e Kosovës, merren ekskluzivisht me rastet. Kur flasim me barazinë gjinore, ne e marrin gjithnjë në kontestin e femrave barazinë gjinore, nuk është ashtu, se në shumë raste diskriminimi gjinor bëhet edhe të burrat. Është bërë mjaft në këtë drejtim, se ne kemi dalë nga një sistem patriarkal, por ende ka nevojë për emancipim e shkollim të gjinisë femërore. Ne po mundohemi përmes kësaj rregulloreje të ecim tutje, këto plane të veprimit të realizohen e mos të mbeten vetëm të shkruara në letër.

z. Vedat Dema- ZBGJ: Në komunën tonë, kur është bërë themelimi i njërive për të drejtat e njeriut, në kuadër të kësaj janë zyrtarët: zyrtari për të drejtat e njeriut, zyrtari për komunitet dhe kthim dhe zyrtari për të drejtat e fëmijëve. Në zyrën për barazi gjinore ka edhe komuna tjera që ka zyrtarë të gjinisë mashkull. Ne si zyrë kemi mbajtur aktivitete në bazë të planit të veprimit. dhe nuk besoj se është ndonjë specifikë që zyra për barazi gjinore me qenë me të punësuar me vetëm femra apo meshkuj, se barazia gjinore ka të bëjë me mbrojtjen e dy gjinive, burrave dhe grave. Sa i përket këtij plani, na obligon Strategjia Kombëtare e Dhunës në Familje, Konventa e Stambollit, si dhe infrastruktura ligjore e Kosovës. Me iniciativën e OSBE është bërë krijimi i mekanizmit 2021 ku ka qenë prezent edhe kryetari i komunës. Me kalimin e kohës, ne jemi të obliguar që ky mekanizëm të vepron. Duke pas parasysh Strategjinë Kombëtare, e kemi bërë këtë plan veprimi duke ia përshtatur specifikave të komunës tonë se bashku me akterët e mekanizmit, ku janë të përfshirë; policia, QPS -zyrtari që merret me rastet e dhunës në familje, arsimi, shëndetësia, e kemi hartuar një plan të kapshëm për me mundur me realizuar. Plani është 3 vjeçar, ka kosto buxhetore ku përfshihen aktivitetet, është përkrahja e strehimores “MY Home” në Ferizaj dhe ne si komunë jemi të obliguar me i dërguar atje me i strehuar. Kjo strehimore e ka për obligim me i strehuar, mirëmbajtur, ushqim etj. se e kemi një marrëveshje që kryetari e ka lidhur me strehimoren, përfshirë edhe mjetet financiare. Në bazë të informatave që i kam, ka ndodhur që nuk i kanë pranuar rastet se nuk kemi dhënë mjete. Në vazhdim z. Vedat Dema i përmendi numrin e rasteve në strehimore sipas viteve.

znj. Ardita Rrahmani: Kam një pyetje për Vedatin: Ka kohë që jeni zyrtar për mbrojtjen e drejtave të njeriut, merreni edhe me dhunën në familje. Cilat kanë qenë rezultatet e punës tuaj

përpos 9 rasteve të cilat janë dërguar në shtëpinë “MY HOME” në Ferizaj, duke ditur se ka raste të dhunës në familje me shumë se 9 raste, se ky është numër i vogël. A ka ndonjë mekanizëm me praktik që me i nxitë njerëzit me i treguar raste, se mund të ndodhë që edhe nëse e mban ndonjë takim në zona të thella malore, nuk besoj se marrin pjesë dhe i lajmërojnë rastet.

z. Vedat Dema: Rastet e dhunës në familje, raportin që e kemi marrë nga policia në vitin 2019 janë 24. Në vitin 2020, 16 raste, 2021, 30 raste. Është e vërtetë se ka raste me tepër marrë parasysh rrethanat që jetojmë, faktori ekonomik social nuk e raporton rastin se nuk ka ku shkon. Për të ardhmen duhet shikuar çka mundemi me bërë që rastet e dhunës në familje me u lajmëruar.

Kryesuesi i Kuvendit: Po të ndërpres Vedat, çështja që nuk keni raportuar rastet nuk është faji i juaj. Ky është plan veprimi e jo raport pune. Në raportet e punës së ekzekutivit të komunës figuron aktiviteti i ZBGJ. Nëse i shohim statistikën, ne si Kaçanik mundemi me u krenuar se ka pak raste të dhunës në familje.

Kryetari i Komunës: Meqë po bëhet fjalë për planin e veprimit, duhet të fokusoheni që me shtuar apo me hequr diçka, ndonjë sugjerim apo vërejtje. Për temën që u ngrit, unë kisha thënë me një propozim të juaj në KK e kishim debatuar me gjatë këtë çështje.

znj. Kadrije Lika-Troni: Me herët Vedati e përmendi që ka pasur raste të dhunës që nuk janë trajtuar as në strehimoren “MY HOME” në Ferizaj, për shkak se nuk iu është bërë pagesa shtëpisë ku trajtohen. Çka ka ndodhur me raste të tilla, ku janë trajtuar ato raste?

z. Vedat Dema: Ne kemi pasur marrëveshje bashkëpunimi dhe komuna jonë është zotuar se ka me iu ndihmuar strehimores, është edhe zyrtari që merret me rastet e dhunës në familje. Nëse nuk ka pasur mundësi me u trajtuar në strehimoren “MY HOME” në Ferizaj, ka shkuar në ndonjë strehimore tjetër. Në plan të veprimit për 3 vjet janë paraparë 3.000€ për strehimoren “MY HOME” në Ferizaj.

znj. Ardita Rrahmani: Të çështja e fuqizimit të rolit të gruas në shoqëri, përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse, ndarja e përvojave aktivitetet që i kanë parapara, mundohen me u realizuar edhe përmes grupit të grave asamblistë. Unë kam kërkuar me u formuar Grupi i Grave Asambleiste, por ky grup nuk është formuar ende. Do të ishte mirë dhe është e nevojshëm me u formuar në mbledhjen e KK ky grup i grave. Në mandatin e kaluar sa e di unë ka qenë i formuar grupi i grave, por mjetet nuk ka pasur të ndara për aktivitetet e këtij grupi.

z. Vedat Dema: Grupi i grave është formuar çdo herë pas zgjedhjeve të reja. Unë kam marrë sa herë iniciativë e kemi themeluar Grupin e grave, e kemi bërë Planin e veprimit. Aktivitetet e mia që i kam pasur për barazi gjinore i kemi bërë me grupin e grave, për arsye se ju jeni ato që përfaqësoni një komunitet dhe jam i gatshëm për bashkëpunim. Me vjen keq që në mandatin e kaluar nuk ka pasur bashkëpunim të mirëfillta edhe pse jam munduar, nuk kanë shprehur interesim dhe unë si zyrtar për barazi gjinore nuk jam i obliguar çdo herë t’iu ofroj bashkëpunim, nëse nuk jeni të interesuar. Ne në bashkëpunim edhe me juve, OSBE mundem me formuar Grupin e Grave Asambleiste (GGA) me bërë edhe planin e veprimit dhe aktivitetet që mundem me i realizuar. Fushata vetëdijesimi qoftë për fuqizimin e gruas në vendimmarrje, trashëgimi, kam mbajtur rregullisht për çështjen e barazisë gjinore, falë bashkëpunimit me drejtorin e arsimit. Nëse ka pasur aktivitete GGA është financuar nga zyra për barazi gjinore.

z. Bahri Selimi: Nuk mundet me pasur kod të veçantë për aktivitete të Grupit të grave. Mjetet për aktivitetet e këtij grupi janë të parapara të Zyra e KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Grupin e Grave Asambleiste që dy mbledhje iu kam thënë me u ndalë e me formuar, por ju nuk keni qenë të gjitha të pajtimit me qëndruar pas mbledhjes. Në mbledhjen e KK, pas anëtarët asambleiste ndaleni dhe e formojmë këtë grup të grave. Sa i përket mjeteve për aktivitete, ju Arditë e dini sesi bëhet shpenzimi i parasë publike, se keni punuar në institucione. Grupi i grave duhet me pasur projekte, duhet me pasur mbulesë për mjetet që ndahen. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Planin e Veprimit për parandalimin e dhunës në familje, 2023-2025. Ky plan i veprimit, Rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është prezentë, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Shprehi shqetësime për rënien e numrit të nxënësve në dy shkollat e mesme, ky fakt duhet të jetë shqetësim për të gjithë. Komuna duhet pasur ndonjë mekanizëm me i stimuluar nxënësit me vazhduar mësimin në shkollat e mesme.

Kryesuesi i Kuvendit: Është e vërtetë se numri i nxënësve të shkollave të mesme dita ditës është në rënie, se nxënësit po shkojnë në komuna tjera si, Ferizaj, Viti etj. për shkak të drejtimit dhe afërsisë. Nuk ka ligj që e specifikon apo ndalon striktë këtë çështje. Drejtori mund të na jep sqarime me të hollësishme për këtë çështje.

z. Zahir Doda: Informatat është në obligimin tonë me ia adresuar KK për informim, për shkak të peshës që ka arsimi, ndërkaq nuk votohen informatat, vetëm debatohet për to. Fillimi i vitit shkollor në tërë Kosovën dihet si ishte për shkak të grevës, uroj që kjo mos të ndodhë më. Informata është me të dhëna konkrete të pasqyruara, të dhënat janë të sakta, gjendja është kjo që është si në informatë.

znj. Kadrije Lika Troni: Për nxënësit të cilët e përsërisin vitin, ata mund edhe të bulëzohen. A keni planifikuar ndonjë trajtim të veçantë për ta ? Pavarësisht sesa kanë qenë problematik ata nxënës, duhet me bërë diçka në këtë drejtim, se në kohën e fundit fëmijët shumë po bulëzohen. Unë kam dëgjuar për bulëzim të nxënësve në mënyrën me të ulët, kështu a është planifikuar ndonjë trajtim i tyre nga ndonjë psikolog ?

z. Zahir Doda: Në kuadër të kësaj, unë kam arritur me plotësuar numrin e psikologëve 5 psikolog të punësuar në shkollë plus 1 psikolog është në proces që me i bërë 6 psikolog brenda sistemit tonë. Për 6 mijë nxënës, nga 1 mijë nxënës 1 psikolog, se kjo është shtylla kryesore që mundën me iu ndihmuar nxënësve dhe me zbutë këtë dukuri. I kemi 2 pedagog të punësuar në shkollë. Kjo dukuri është evidente në shkollë me çka e kam vërtetuar edhe vet fjalorin e tyre që përdorin etj., jemi munduar me iu ndihmuar në këtë çështje edhe me ligjërata të ndryshme në shkollë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të ndarja e bursave për nxënës të SHMP, kujtoj se është bërë diskriminim, sado që kjo ka qenë një politikë me i nxitur nxënësit me shkuar në atë shkollë, sepse ka rënë interesimi i nxënësve me u regjistruar në SHMP. Secili nxënës shkon në shkollë me nxënë dije. Nxënësit kur janë të njëjtës moshë me bërë dallime, kujtoj se është diskriminim me bërë ndarje të bursave vetëm në njërën shkollë. Unë kam pasur ankesa nga prindërit e nxënësve të

shkollës së mesme “Skënderbeu”, se janë diskriminuar në këtë drejtim nxënësit që janë në këtë shkollë.

z. Zahir Doda: Është menduar kjo, prindërit janë drejtuar edhe të unë, por nuk ka mundësi buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky hap është shumë i mirë që është bërë, se kjo ndodhë edhe në universitete. Shumë drejtime që kanë mungesë të studentëve, universiteti jep edhe bursa dhe ua mbulon shpenzimet tjera, vetëm me pasur studentë në drejtime të caktuara. Nuk është diskriminim, por stimulim me i nxitur nxënësit me u regjistruar në atë shkollë. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Diskutoj

Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor 2022/2023 dhe e njëjta i kalohet KK në procedurë për diskutim.

6. Informatë për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika-Troni: A mos pak e vonuar kjo informatë, mos është dashur me ardhur në muajin korrik apo në muajin gusht ?

z. Zahir Doda: Jo, në planin e punës së KK thuhet, Informata për fillimin e vitit shkollor duhet me u debatuar në shtator, kurse atë të përfundimit shkollor në muajin tetor. Mua mi ka zënë dy informatat muaji tetor, pasi në shtator nuk filloj viti shkollor për shkak të grevës, përndryshe edhe mua me është dukur jo në rregull. Nëse e ndërroni me plan të punës së KK, për mua nuk prishë punë.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor, ka arsye pse është Informata për fillimin e vitit shkollor me herët se ajo e përfundimit. Për fillimin e vitit shkollor i keni të dhënat dhe hartohet informata, ndërkaq për përfundimin e vitit shkollor, përpunohen të dhënat. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Diskutoj

Informatën për përfundimin e Vitit shkollor 2021/2022 dhe e njëjta i kalohet KK në procedurë për diskutim.

7. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë;

Kryesuesi i Kuvendit: Propozimi ka ardhur nga unë. Vizita është e paraparë edhe në planin e punës së KK, gati se edhe në vitet tjera kemi realizuar vizita zyrtare dhe e kanë pasur efektin e vet. E kemi quajtur studimore, për faktin se ende nuk kemi ftesë për me quajtur zyrtare, sigurisht se ftesa do t’na vjen. E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Është për t’u përshëndetur realizimin i kësaj vizite, ndërkaq nuk pajtohem të quajmë vizitë studimore, përveç së një lloj ekskursioni që do të realizohet në Shqipëri. Ajo që është për me u përshëndetur (e them me ironi) ne nuk po realizojmë vizita ndonjë vizitë zyrtare për me përfituar ndonjë ide etj., përpos një ekskursioni të cilën mundem me realizuar edhe privatisht. Pavarësisht kostos dhe atyre që marrin pjesë, nuk po paragjykoj, se unë këtë herë nuk mundem me marrë pjesë, do ishte mirë të takojmë dike nga përfaqësuesit e institucioneve si

asamblenë komunale dhe me arritur me krijuar raporte miqësore, pse jo edhe me na vizituar edhe komunën tonë, me lidhur raporte qoftë në aspektin kulturor apo në ndonjë fushë tjetër, të komunave si motra.

Kryesuesi i Kuvendit: Në këto vizita ka me pasur takime të nivelit bashkiak, por nuk i kemi siguruar ende se në cilat bashki do të realizohen. Vizita të tilla i kemi realizuar çdo herë. Këtë herë nuk i kam quajtur vizita zyrtare pa e ditur se cilat bashki kemi me i vizituar. I kam paraprakisht orientimet në 3 apo 4 vende, por ende nuk me është konfirmuar. Itinerarin kemi me caktuar me shefat e grupeve parlamentare. Vizitat e deritanishme nuk kanë qenë turistike edhe pse janë munduar me i quajtur turistike dhe ato vizita pos tjerash kanë ndikuar në përafrimin e anëtarëve të KK pozitë-opozitë. A nuk të duket shumë e rëndësishme që KK me vizituar Beratin, Gjirokastrën si qytete në mbrojtje të UNESCO e që vizitohen nga grupe politike e jo politike nga mbarë bota. Ka anëtarë të KK që nuk ka vizituar asnjëherë këto vende. Nuk ka keqpërdorim të parasë publike me këto vizita, vizita është në interes të KK me dalë e me pa, këto vizita kanë ndikuar në relaksim dhe krijimin e raporteve mes subjekteve politike.

znj. Ardita Rrahmani: Cilat kanë qenë rezultatet e vizitave të cilat i keni realizuar më herët, përveç raporteve kolegjiale, fjala vjen e keni vizituar bashkinë e Beratit, çka i ka sjellë ajo vizitë një anëtarit të KK? Pse mos me marrë iniciativa që edhe ne me i ftuar për vizita zyrtare në komunën tonë ndonjë komunë, me shkëmbyer përvoja të ndryshme ?

Kryesuesi i Kuvendit: Në bashkinë e Beratit jemi pritur nga përfaqësuesit e institucioneve, kemi vizituar sallën ku mbajnë seancat, janë diskutuar çështje me interes në fushën trashëgimisë kulturore, kemi vizituar monumente historike kulturore. Secili anëtar që ka qenë i ka interesuar, ka pasur mundësi me përfutur shumë nga fusha e trashëgimisë kulturore. Ata kanë shumë burime të mëdha në fushën e trashëgimisë kulturore, diçka mundemi me marrë nga ata në këtë fushë, si të çështja e muzeut etj. Janë diskutuar edhe tema në fushën e bujqësisë, jemi njoftuar edhe me çështjen e kompensimeve të tyre, ku jemi njoftuar se ata e ndjekin një rrugë evropiane me punuar pa pagesë. Iniciativa ka pasur me i ftuar për Ditën e Çlirimit të Komunës ata të bashkisë së Elbasanit, nuk e realizuam për shkak të një rasti që patën ata të bashkisë. Shpenzimet buxhetore i bartë komuna jonë. Në këtë bashkinë e Beratit na kanë dhënë një drekë, ndërkaq sesa munden bashkitë me nda mjete për vizita të tilla me na vizituar ne, unë nuk e di, përndryshe vizita nuk kanë karakter ekskursioni. KK kanë nevojë për me shumë me dalë, me pasur trajnime, kemi qenë të interesuar me pasur trajnime këtu në Kaçanik, por iniciativa të tilla nuk po funksionojnë pa shkuar diku me larg. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për realizimin e një vizite studimore e Kuvendit të Komunës Kaçanik në Republikën e Shqipërisë. Ky propozim vendim i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

8. Propozim Vendimi për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin për transfer të mjeteve sipas buxhetit të vitit 2022. Ky propozim Vendim i,

Rekomandohet
Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

9. Propozim Vendimi për transferim dhe rialokim të mjeteve buxhetore;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj
Propozim Vendimin për transferim dhe rialokim të mjeteve buxhetore. Ky propozim
Vendim i,

Rekomandohet
Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:12. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjashtë anëtarët e KPF që ishin prezentë në këtë mbledhje. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 26 Tetor 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	10.11.22	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.	Numri	Shtojcë	
	01	106/02-30293	/.	

STRATEGJIA PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2023 – 2026

SHKURTESAT

IT	Teknologji e Informacionit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SWOT	Strengths-Weaknesses-Opportunities-Threats
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	4
2.	SFONDI.....	4
2.1.	Profili i komunës.....	4
2.2.	Administrata komunale.....	5
2.3.	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.....	6
2.4.	Korniza ligjore.....	6
3.	GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET.....	7
3.1.	Websajti i komunës dhe platformat sociale.....	7
3.2.	Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje.....	8
3.3.	Marrëdhëniet me mediat.....	8
3.4.	Komunikimi i brendshëm.....	8
3.5.	Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë.....	9
3.6.	Promovimi dhe marketingu i Komunës.....	9
3.7.	Vlerësimi vetanak - Analiza SWOT.....	9
4.	PARIMET E KOMUNIKIMIT.....	10
5.	OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT.....	11
1.	Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale.....	11
2.	Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat.....	11
3.	Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.....	12
6.	KANALET E KOMUNIKIMIT.....	12
7.	AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR.....	14
8.	PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI.....	16
9.	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË.....	16
	Shtojca I: Plani vjetor për informim dhe komunikim 2022.....	17

I. HYRJE

Komuna e Kaçanikut ka krijuar një përvojë në përgatitjen e dokumenteve që promovojnë transparencën komunale.

Në vazhden e këtyre përpjekjeve, Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren komunale për transparencë me synimin që ta harmonizojë atë me ndryshimet në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së 04/2018 mbi Transparencën e Komunave. Ky veprim është pasuar me hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë 2019-2023, si një dokument i rëndësishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë.

Strategjia për Informim dhe Komunikim 2022-2025 është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë duke përfutur nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i mediave të reja si kanale të komunikimit. Përmes këtij dokumenti do të kërkohet një reagim proaktiv i audiencave ndaj aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës. Kjo do të arrihet përmes thellimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme duke përdorur kanale të përshtatshme dhe efikase të komunikimit. Së këndejmi, *Strategjia për Informim dhe Komunikim 2022-2025* është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të ndërveprimit me aktorë të ndryshëm ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm, si një komponentë që përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të *Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2022-2025*, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, kurse në raste të veçuara do të angazhojë edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.

Aktivitetet e parapara me këtë strategji janë dizajnuar mbi bazën e një analize gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në disa elemente kyçe. Mbi bazën e kësaj analize janë identifikuar mundësitë për përmirësim, të cilat janë përkthyer në objektiva, mesazhe dhe kanale të komunikimit dhe mekanizma për marrjen e informatave kthyesë.

2. SFONDI

2.1. Profili i komunës

Kaçaniku ndodhet në juglindje të Republikës së Kosovës dhe kufizohet në jug me Komunën e Hanit të Elezit, në lindje me Shtërpçën, në veri me Komunën e Ferizaj dhe në perëndim me Komunën e Vitisë. Kaçaniku si qendër administrative - (Fshat)Pastaj edhe si qytezë, daton qysh nga fundi i shekullit XVI.

Deri në vitin 1891 ishte nahije e Sanxhakut të Shkupit të Vilajetit të Kosovës. Sipas të dhënave historike, themelues i qytezës Kaçanik është Koxha Sinan Pasha, një pasha turk me origjinë shqiptare. Sinan Pasha ndërtoi xhaminë (e cila edhe sot ekziston), një imaret (kuzhinë publike), një shkollë në afërsi të xhamisë, dy hane (bujtina), një hamam (banjo publike), kalanë dhe disa mullinj mbi lumin Lepenc.

Kaçaniku dallohet me faktin se përmes tij kalojnë 2 lumenj, Lepenci dhe Nerodimja, të cilët në fund të qytetit bashkohen. Veç 2 lumenjve, i ka edhe 2 zona klimatike.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në regjistrimin e fundit të popullsisë në Komunën e Kaçanikut janë rreth 33,409 banorë.

Kaçaniku ka edhe pasuri natyrore të pyjeve, tokës dhe ujërave, ndërsa vlerësohet si ndër vendet më të pasura shqiptare me pyje të bollshme e të bukura. Qyteti i Kaçanikut është i pasur me vende të bukura të trashëgimisë kulturore, natyrore e historike. Ky qytet njihet në histori për qëndresën kombëtare në luftë kundër armikut.

2.2. Administrata komunale

Administrata komunale në Kaçanik është e organizuar në 9 drejtori: Drejtoria për Administratë e Përgjithshme, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport.

Në kuadër të administratës, më saktësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: Zyra ligjore, Zyra për Integritet Evropian, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra për Auditim të Brendshëm, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyra e IT-së, Zyra e Kuvendit, Zyra e Prokurimit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Barazi Gjinore dhe Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut.

Misioni i Komunës:

"Ofrimi i mbështetjes për të gjithë qytetarët, investimet kapitale dhe shërbimet administrative të përditshme duke siguruar koordinim, bashkëpunim dhe transparencë midis Ministrive, Komunës, Drejtorive, Zyrave, Shoqërisë Civile dhe Partnerëve tjerë në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase ndaj qytetarëve të Kaçanikut"

2.3. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në administratën komunale të Kaçanikut përbëhet nga vetëm një zyrtar për informim publik, i cili mbështetet nga zyrtari për teknologji të informacionit.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun kujdeset për transparencën e qeverisjes kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, drejtorive dhe njësive tjera të ekzekutivit.

Në kuadër të funksioneve të saj, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun koordinon konceptimin, organizimin dhe zbatimin e fushatave me karakter informues apo të ndërgjegjësimit. Sektori mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre.

Më tej, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun mirëmban webfaqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë, me mbështetje të zyrtarit për teknologji informative.

2.4. Korniza ligjore

Hartimi i kësaj Strategjie është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L 040 - obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Statuti i Komunës së Kaçanikut –përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

Rregullorja për transparencë – përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Kaçanikut dhe të zyrtarëve komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në proceset e vendimmarrjes në komunë.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215 - garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara, apo të pranuar nga institucionet publike.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna – përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave, rregulloreve dhe akteve nënligjore të komunës.

Udhëzimi Administrativ nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna - ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike - është dokument që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha ueb-faqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave.

3. GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIMET

Viteve të fundit, Komuna e Kaçanikut ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të diversifikojë kanalet e komunikimit me audiencat të ndryshme me synimin që të sigurojë një informim sa më gjithëpërfshirës, nivel të lartë të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe një ndërveprim të intensiv me mediat dhe publikun, hisedarët, partnerët dhe donatorët e komunës. Ky komunikim përgjithësisht është realizuar përmes komunikatave për media, intervistave, tabelave të shpalljeve, kontakteve dhe vizitave të drejtpërdrejta me qytetarë, takimeve me Këshillat e Fshatrave, takimeve me organizatat e shoqërisë civile, kontakteve afaristë, investitorë dhe donatorë, si vendorë ashtu edhe të jashtëm. Pa dyshim, kanalet më të rëndësishme të komunikimit që komuna sot ka në dispozicion janë uebsajti i komunës, llogaritë e komunës në Facebook dhe YouTube.

3.1. Websajti i komunës dhe platformat sociale

Komuna përgjatë dy viteve të fundit ka bërë shumë përpjekje që të sigurojë publikimin e të gjitha dokumenteve me rëndësi në uebsajtin e komunës. Komuna ka arritur të krijojë një infrastrukturë të mirë për të gjithë ata që kërkojnë informacione në uebsajt. Është arritur që kategoritë kryesore, si: Kuvendi, Kryetari, Financat, Investimet, Lajmet, Konsultimet Publike dhe Prokurimi të jenë të pajisura me të gjitha informacionet e mundshme. Në vitet në vijim, Zyra për Informim në bashkëpunim me drejtoritë komunale do të vazhdojë ta avancojë përmbajtjen e faqes zyrtare në përputhje me kërkesat e kohës dhe *Doracakun mbi Procedurat Standarde të Publikimit të Akteve dhe Dokumenteve Komunale në Uebfaqet e Komunave* të hartuar nga MAPL në bashkëpunim me donatorë që përkrahin këto procese.

Përveç uebsajtit, komuna është e pranishme me llogarinë e saj në Facebook, e cila në vazhdimësi ofron informacione mbi ngjarjet dhe aktivitetet e administratës komunale dhe Kuvendit. Në këtë

drejtim, përveç rritjes së numrit të ndjekësve në rrjetet sociale, fokusi i Komunës për vitet në vijim është që përmbajtjen e informacioneve dhe mesazheve t'ia adaptojë natyrës specifike të platformave për komunikim social, në mënyrë që postimet e saj të jenë më tërheqëse për publikun e të gjitha moshave.

3.2. Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Kuvendi Komunës ka miratuar rregulloren mbi transparencën me synimin që ta harmonizojë atë me ndryshimet më të fundit në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së 04/2018 mbi Transparencën e Komunave. Ky veprim është pasuar me hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë 2019-2022, si një dokument i rëndësishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë.

3.3. Marrëdhëniet me mediat

Zyra Komunale për Informim në Kaçanik përbëhet nga vetëm një zyrtar, i cili asistohet nga Zyra IT. Duke pasur parasysh madhësinë e komunës, mund të thuhet se personeli i angazhuar, në numër edhe në kompetenca profesionale, është i pamjaftueshëm për të administruar me efikasitet punën e informimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe mediat.

Aktualisht, në territorin e Komunës së Kaçanikut nuk operon asnjë televizion lokal dhe asnjë radio lokale, dhe kjo mund të jetë si një mangësi e sidomos duke marrë parasysh se spektri ekzistues i mediave me frekuenca kombëtare për të përcjellë ngjarjet në nivele lokale është zbehur shumë viteve të fundit.

Gjatë viteve në vijim, komuna do të kërkojë që të rrisë nivelin e komunikimeve duke u bazuar mbi praktikën tashmë të etabluar të komunikimit, profesionalizmin e zyrës për informim si dhe marrëdhënieve të shëndosha me mediat të ndërtuara ndër vite. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të shtuar të mediave elektronike, platformat e komunikimit social, produksionit vizual dhe transmetimeve nga vendi i ngjarjes (livestreaming).

3.4. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi brenda për brenda administratës komunale është avancuar organikisht përgjatë viteve dhe përbën një shtyllë të fortë që ka mbështetur komunikimin e jashtëm, por edhe ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e praktikave të punës dhe motivimin e personelit për të përballuar me sukses dinamikën në rritje të qeverisjes lokale. Pavarësisht nga kjo, ka hapësira për ndërhyrje në mënyrë që të sigurohet një komunikim edhe më efikas në të gjitha drejtimet.

Synimi i planifikimit të komunikimit të brendshëm përmes *Strategjisë Komunale për Informim dhe Komunikim 2023-2026* është që të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët (komunikim nga lart-poshtë), shkëmbime ndërsektoriale (komunikim i tërthortë) dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon dëgjimin e zërit të secilit (nga poshtë-lart).

3.5. Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë

Komuna vazhdon të kultivojë një bashkëpunim të shëndoshë me organizatat e shoqërisë civile. Organizata joqeveritare vendore kanë një trajtim të veçantë kur është fjala për pjesëmarrjen e tyre në ngjarjet komunale, hartimin e politikave dhe pasurimin e legjislacionit, apo çështjeve të tjera me interes publik. Për më tepër, OJQ-të vendore janë të përfshira në organizimin e shumë ngjarjeve publike që kanë për qëllim rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit me organet shtetërore, përfaqësive diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare me synimin e bashkërendimit të veprimeve në funksion të ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme të komunës në sferën e qeverisjes së mirë, mirëqenies së qytetarëve, por edhe në avancimin e infrastrukturës komunale përmes projekteve kapitale. Komuna edhe në të ardhmen do të vazhdojë të kultivojë marrëdhënie të shëndosha me aktorët e këtij niveli në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e madhe për projektet dhe nismat që tejkalojnë kapacitetet vetanake të komunës.

3.6. Promovimi dhe marketingu i Komunës

Në një stad zhvillimi që ka arritur sot, komuna ka nevojë që të rrisë ndjeshëm nivelin e promovimit dhe marketingut të aseteve dhe pasurive të trashëgimisë kulturore, historike, turistike apo ekonomike. Komuna duhet të hulumtojë për forma kreative dhe ekonomikisht të përballueshme në promovimin e vlerave të saj, qoftë në formë të printuar apo digjitale.

Ndarja e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik nga ajo e Financave si dhe ndarja e Drejtorisë së Kulturës nga ajo e Arsimit, janë disa nga hapat që duhet konsideruar në nisje, dhe e gjithë kjo do të duhej të kulminonte me hartimin e një strategjie të konsoliduar për promovimin dhe marketingun e komunës.

3.7. Vlerësimi vetanak - Analiza SWOT

Analiza SWOT është kryer me qëllim që të merret një vlerësim vetanak i zyrtarëve të përfshirë në procesin e hartimit të kësaj strategjie të komunikimit duke marrë në konsideratë përparësitë, dobësitë, mundësitë për përmirësim, si dhe rreziqet eventual në raport me komunikimin efikas të administratës komunale. Më poshtë janë paraqitur vlerësimet e përgjithshme.

PËRPARËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT

- Praktikë pozitive të komunikimit të brendshëm
- Kapacitetet dhe aftësitë profesionale të ZIMP për të ndërtuar përcjellë mesazhe të qarta dhe koncize.
- Marrëdhëniet profesionale me përfaqësues të OJQ-ve

DOBËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT

- Mungesa e burimeve njerëzore në ZIMP
- Interesimi në zbehje të mediave me frekuenca kombëtare për të ndjekur ngjarje të nivelit lokal
- Mosnjohja e duhur e qytetarëve mbi besueshmërinë e lajmeve që plasohen nga mediat online (portalet)
- Mungesa e një Televizioni apo radio në Kaçanik

MUNDËSITË PËR RITJE TË EFIKASITETIT

- Shtimi i kapaciteteve njerëzore në ZIMP
- Përdorimi shtuar i teknologjisë në rritjen e efikasitetit në komunikim me audiencat e ndryshme (mediat, grupet profesionale, OJQ-të, institucionet akademike, etj.)
- Krijimi njësive të identitetit vizual të komunës dhe brendimi (vizioni, slogani, mesazhet promovuese, etj.) në funksion të arritjes së objektivave të komunikimit.

RREZIQET E MUNDSHME

- Mundësitë e kufizuara financiare të komunës për të mbështetur një plan intensiv komunikimi.
- Tendencë në rritje e qytetarëve që informohen përmes burimeve dhe medimeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi.
- Rritja e vazhdueshme pritjeve për shërbime më cilësore

4. PARIMET E KOMUNIKIMIT

Parimet e komunës për informim dhe komunikim do të bazohen në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohshme në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok. Këto parime mbështeten në elementet e mëposhtme:

Informimi i kohshëm – nënkupton përpjekje të vazhdueshme për informim të kohshëm në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e saj në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e pranuar.

Ndërveprimi – nënkupton ofrimin e mundësisë për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo më pastaj i mundëson komunës që të ndër marrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të performancës së saj.

Përfshirja dhe mos-diskriminimi – Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit me synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni.

Transparenca dhe llogaridhënia – Udhëheqësit e komunës do të mbështeten në praktikën më të mira të transparencës dhe llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës.

Shumëllojshmëria – nënkupton shfrytëzimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetatat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, programet aplikacionet specifike të komunës etj.

5. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Komuna e Kaçanikut synon që në vitet pasuese të krijojë një mekanizëm të qëndrueshëm të komunikimit të brendshëm, i cili do të shërbente si një bazament solid për të mbështetur komunikimin me aktorë të jashtëm dhe të marrëdhënieve me mediat, në mënyrë që të promovojë me korrektësi aktivitetet dhe të arriturat e veta, të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, të shtojë dukshmërinë e vet para publikut, qoftë përmes paraqitjeve sistematike në publik ashtu edhe përmes përdorimit të mediave të reja.

Pavarësisht rezultateve mbresëlënëse të evidentuara gjatë viteve të fundit në fushën e informimit, transparencës dhe llogaridhënies, ekzistojnë hapësira për përmirësim të mëtejshëm në vitet në vijim, sidomos në drejtim të përdorimit të shtuar teknologjisë në komunikimet me audiencat e ndryshme, shtimit të burimeve njerëzore brenda Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, si dhe në promovimin më të mirë të komunës dhe aseteve zhvillimore.

Përmes planeve vjetore të komunikimit komuna do të synojë që të intensifikojë edhe marrëdhëniet me mediat dhe publikun e gjerë, në mënyrë që të amortizojë tendencat në rritje të qytetarëve që të informohen përmes burimeve dhe mediumeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi.

Duke u nisur nga analiza e gjendjes aktuale me komunikimet, Komuna e Kaçanikut ka përcaktuar tre (3) objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen përmes kësaj strategjie:

- 1. Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale**
- 2. Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me media**
- 3. Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë**

1. Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale

Komunikimi i brendshëm është një komponentë e rëndësishme e institucioneve publike dhe jo vetëm, sidomos të atyre që në përbërjen dhe natyrën e vet janë më komplekse siç është rasti me administratat komunale. Komuna do të ndërmarrë veprimet e duhura për të ndërtuar një kulturë ku të punësuarit në administratën komunale ndjehen rehat dhe kanë besimin e mjaftueshëm për të shprehur mendimet e tyre në funksion të rritjes së rendimentit të punës dhe cilësisë së shërbimeve. Qëllimi parësor i avancimit të komunikimit të brendshëm është që ta bëjë administratën komunale një institucion të aftë për t'i paraprirë ndryshimeve.

2. Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat

Stadi zhvillimor në të cilin ndodhet aktualisht komuna e Kaçanikut kërkon një rishikim prioritetesh ashtu që vëmendja në të ardhmen të përqendrohet te paraqitjet e strukturuar mediale, diversifikimit të kanaleve dhe materialeve komunikuese, përdorimit të shtuar të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në Internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të rrisë praninë e saj në platformat sociale, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Përpara hapjes së llogarive në platformat e tjera sociale, Komuna do të sigurohet që personeli në ZIMP të trajnohet për përdorimin efikas të tyre. Po ashtu, një vëmendje veçantë do t'i kushtohet konsolidimit

të marrëdhënieve me mediat, të cilat numerikisht janë të konsiderueshme dhe mund të ofrojnë një ndihmë të madhe në informimin e drejtë dhe të saktë në raport me veprimtarinë e institucioneve komunale.

3. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje

Synimi parësor i kësaj Strategjie është që t'i mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitete të Komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të aplikojë një qasje komunikimi e cila hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Thënë këtë, përmes kësaj strategjie komuna do të mirëmbajë mekanizimin efikas të transparencës, dhe do të stimulojë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje duke kultivuar një bashkëpunim të avancuar me organizatat lokale të shoqërisë civile. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të komunikimit digjital, sidomos në raport me informimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit në vendimmarrjen komunale.

6. KANALET E KOMUNIKIMIT

Në dritën e zhvillimeve teknologjike, Komuna e Kaçanikut do të angazhohet që komunikimet në vitet pasuese të përqendrohen te mediat e reja, të cilat mundësojnë një efikasitet më të lartë dhe ndërveprim të shtuar me të gjitha audiencat – qofshin të brendshme apo të jashtme. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës brenda përbrenda administratës komunale dhe me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

Emaili - Në një institucion zyrtar, emaili është një kanal i pazëvendësueshëm komunikimi edhe për faktin se përmbajtjet e mesazheve të emailit kanë pothuajse një status të komunikimit zyrtar. Duke pasur parasysh këtë fakt, është shumë me rëndësi që të punësuarit administratën komunale t'i avancojnë njohuritë për përdorimin e duhur dhe efikas të llogarive zyrtare, përtej normave të përcaktuara me rregullore dhe udhëzime administrative. Për këtë arsye, që në vitin e parë të kësaj Strategjie, Komuna do të shpërndajë *Udhëzuesin për përdorimin e duhur dhe efikas të komunikimit me email*.

Intraneti qeveritar - Është një platformë e mirë për vendosjen e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve relevante në një vend të vetëm, mundëson një qarkullim të lirë të informacionit dhe përbën një medium ku të punësuarit mund të shprehin idetë dhe mendimet e tyre.

Aplikacionet qeveritare - janë një mundësi e mirë për komunikim dhe koordinim të brendshëm dhe ndërinstitutional sepse ofrojnë mundësojnë komunikimin përmes pajisjeve që sot secili i punësuar i ka në dispozicion. Në të ardhmen Komuna do të përpiqet që të shtojë përdorimin e aplikacioneve zyrtare të licencuara dhe që janë në pronësi të Qeverisë, si për shembull *Skype for Business* dhe *Microsoft Teams*.

Webfaqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/kacanik/> mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Së këndejmi, faqja zyrtare në internet do të mirëmbahet rregullisht dhe do të shërbejë si një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm i informimit për qytetarët e komunës dhe palët tjera të interesuara.

Platformat e komunikimit social – Duke pasur parasysh rritjen gjithnjë e më të madhe të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna do të kërkojë për forma më efikase të pranisë së vet në platformat sociale. Në momentin aktual, Komuna e Kaçanikut është e pranishme në platformën sociale Facebook dhe YouTube. Prania në platformat tjera sociale është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2022) me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

Mediat – Komuna në vazhdimësi është përpjekur të kultivojë marrëdhënie profesionale me përfaqësuesit e mediave. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun do të krijojë lista të konsoliduar të mediave me frekuenca lokale (Nëse hapet ndonjë medium i ri) e kombëtare me qëllim që të pasqyrojë ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut.

Paraqitjet publike dhe në media – janë një formë efikase për t'iu drejtuar audiencave të ndryshme për çështje specifike dhe me rëndësi për zhvillimet në komunë. Në këtë kuadër do të intensifikohen konferencat për shtyp (të rregullta dhe të rastit), intervistat dhe debatet në media, takime jorformale me përfaqësuesit e mediave, inaugurime dhe promovim e nismave të ndryshme, shkrime autoriale dhe opinione për çështje specifike që ndërlidhen me qeverisjen lokale, etj.

Publikimet - janë një aspekt kyç i punës së komunës dhe prezantimit të saj. Ana përmbajtësore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe vizualisht më estetike, e për rrjedhojë edhe më të lexueshme nga publiku dhe grupet e interesuara. Po ashtu, si publikimet formale ashtu edhe ato me karakter promovimi dhe marketingu apo ato me karakter informimi e ndërgjegjësimi do të standardizohen në mënyrë që të arrihen standarde të pranueshme të vizibilitetit.

Videot dhe fotografitë - Rëndësia e imazheve (videot dhe fotografitë) në komunikimet digjitale është rritur në mënyrë dramatike që nga dalja në skenë e platformave për komunikim social. Videot dhe fotografitë, edhe si të vetme dhe e pashoqëruar me narracion, ka aftësinë për të kapur vëmendjen e audiencës, duke gjeneruar interesim dhe përfshirje të madhe.

Takime të strukturuar dhe të planifikuara për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve publike të natyrave konsultative – takimet dhe debatet publike, takimet konsultative, dëgjimet buxhetore, takimet komunitare për nisma dhe projekte kapitale, etj.

Tabelat e informimit – Komuna do të përkujdeset që në vendet më të frekuentuara të zonave urbane dhe rurale të vendosë tabelat të informimit të qytetarëve, në mënyrë që njoftimet, informacionet dhe mesazhet që duhen përcjellë te qytetarët të jenë të dukshme dhe të disponueshme për sa më shumë të interesuar.

7. AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Përmes kësaj strategjie komuna e Kaçanikut kërkon të vendosë marrëdhënie të shëndosha dhe me interes reciprok me një numër të madh audiencash duke përcjellë mesazhe e duhura te audiencat e caktuara dhe duke respektuar mendimin e tyre në raport me çështjet e përbashkëta të interesit.

Në këtë aspekt, është e rëndësishme që audiencave të caktuara t'ia përcjellim mesazhet e duhura në mënyrë që jo vetëm t'i informojmë për synimet dhe qëndrimet tona, por edhe që të ndikojmë në përmirësimin e mendimit të tyre për punën që bëhet nga komuna dhe eventualisht t'i bëjmë që të flasin pozitivisht dhe të avokojnë për interesat e komunës.

Tabela më vijim, paraqet në formë të detajuar audiencat me të cilat synon të komunikojë komuna në një mënyrë të organizuar dhe të strukturuar përmes mesazheve të qarta dhe që nuk lënë hapësira për dëmtimin e marrëdhënieve reciproke.

AUDIENCA	MESAZHI: Çfarë duam që ata të mendojnë për ne?	IMPAKTI I DËSHIRUAR: Çfarë veprimesh presim nga ta?
Të punësuarit në administratën komunale të Kaçanikut	- Administrata komunale bën gjithçka që është e mundur që të jetë një ambient ku të punësuarit mbahen të informuar, dëgjohen dhe mendimet e tyre respektohen; - Administrata komunale është një ambient ku të punësuarit nxiten dhe inkurajohen që gjërat t'i bëjnë më ndryshe dhe më mirë; - Administrata komunale është një ambient ku suksesti festohet, dhe ku meritoret vlerësohen dhe shpërblehen - Administrata komunale është një ambient ku secilit i jepet mundësia për të zhvilluar kapacitetet profesionale.	- Të flasin me pozitivitet mbi ambientin e punës në administratën komunale dhe të promovojnë motivimin për të qenë në shërbim të nevojave dhe interesave të qytetarëve. - Të ndjehen të lirshëm që përvojnë e tyre ta vënë në funksion të nxitjes së risive dhe mënyrave kreative të ofrimit të shërbimeve. - Të jenë insistues në promovimin e meritokracisë dhe shpërblimit të arritjeve personale përtej pritjeve dhe planeve të paracaktuara. - Të bashkëpunojnë ngushtë me njësinë e personelit të administratës në identifikimin e fushave për ngritje profesionale.
Qytetarët dhe taksapaguesit e të gjitha kategorive	- Komuna e Kaçanikut është e përkushtuar që përmirësojë cilësinë e qeverisjes. - Shërbimet e komunës janë me kosto të arsyeshme dhe janë në përmirësim çdo ditë.	- Të shprehen pozitivisht për cilësinë e shërbimeve, qeverisjes dhe demokracisë në komunë. - Të kenë mirëkuptim për efikasitetin dhe koston e shërbimeve që marrin nga komuna.

	• Komuna mirëpret pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në vendimmarrje. • Komuna shpenzon me përgjegjësi dhe efikasitet paratë e taksapaguesve dhe donatorëve.	• Të kenë mirëkuptim për planifikimin e investimeve kapitale dhe rëndësinë e tyre për objektivat zhvillimor. • Të kenë një perceptim pozitiv mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike
Mediat	• Udhëheqja komunale është e përkushtuar për të rritur cilësinë e shërbimeve. • Komuna e Kaçanikut i shpenzon paratë e taksapaguesve në mënyrë të përgjegjshme dhe në interes të zhvillimit të komunës. • Komuna është e hapur ndaj të gjitha interesimeve tuaja. • Mbështetja juaj është e domosdoshme në luftimin e korrupsionit dhe keqqeverisjes.	• Të mbulojnë ngjarjet që ndërlidhen me komunën në mënyrë të kohshme, saktë, të sigurtë dhe të paanshme. • Të raportojnë për nismat dhe projektet pozitive të komunës • Ta konsiderojnë administratën komunale një burim të besueshëm të informacionit. • Të ofrojnë kontributin e tyre në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së qeverisjes
Organizatrat e shoqërisë civile dhe organizatat profesionale	• Komuna është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e OSHC-ve dhe organizatave profesionale • Komuna do të mbështesë nismat dhe projektet e shoqërisë civile që kanë për synim përmirësimin e cilësisë së standardeve demokratike në komunë. • OSHC-të janë një aleat i besueshëm i komunës në avancimin e praktikave të transparencës në shpenzimin e fondeve publike	• Ta konsiderojnë komunën si partner të rëndësishëm në mbështetjen e nismave dhe kauzave të tyre • Të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrje dhe të nxisin pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive • Të mbështesin përpjekjet e komunës për qeverisje gjithëpërfshirëse. • Të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve komunale
Komuniteti i biznesit dhe investitorët e mundshëm	• Komuna e Kaçanikut mbështetë krijimin e një ambienti miqësor për të bërit biznes. • Politikat tona fiskale janë të favorshme për zhvillimin e biznesit. • Administrata komunale është e përkushtuar që të rrisë nivelin e cilësisë së shërbimeve. • Komuna synon të jetë një vend i mundësive dhe nxitëse e inovacionit.	• Ta konsiderojnë komunën si një partner të besueshëm në zhvillimin e bizneseve të tyre. • Të flasin pozitivisht për nismat dhe përpjekjet e komunës në përmirësimin e ambientit afarist në komunë. • Të kontribuojnë profesionalisht në përmirësimin e politikave dhe strategjive zhvillimore. • Të inkurajojnë investitorët e huaj të investojnë në Kaçaniik.
Institucionet e Kosovës (Qeveria,	• Mbështetja e Qeverisë është jashtëzakonisht e rëndësishme për zhvillimin e komunës.	• Të mbështesin vizionin tonë për zhvillim të komunës. • Të kenë parasysh specifikat e komunës dhe nevojave për fonde shtesë.

Kuvendi i Republikës, agjencitë qeveritare, etj)	• Administrata komunale është shumë e motivuar për të rritur cilësinë e shërbimeve. • Investimet kapitale janë gjithmonë të menduara mirë dhe në përputhje me vizionin zhvillimor të komunës. • Komuna ka nevojë për mbështetjen e qeverisë në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme	• Të mbështesin nismat tona dhe kërkesat për investime kapitale. • Të mbështesin kërkesat tona për zhvillimin profesional të personelit të administratës komunale.
Partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët	• Komuna është e përkushtuar të përmirësojë cilësinë e qeverisjes. • Komuna e Kaçanikut i shfrytëzon kontributet e donatorëve në mënyrë të përgjegjshme. • Komuna e Kaçanikut është një partner i besueshëm që kujdeset për qëndrueshmërinë e projekteve dhe investimeve.	• Të flasin me pozitivitet mbi partneritetin me komunën. • Të na mbështesin në avokimin për grumbullimin e fondeve për qëllime zhvillimore. • Të mbështesin komunën në rritjen e cilësisë së qeverisjes, zhvillimit dhe demokracisë.

8. PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI

Zbatimi i kësaj strategjie do të mbështetet në planet vjetore të veprimit. Vlerësimi i zbatimit të planit për komunikim dhe informim do të bëhet mbi baza vjetore nga Kabineti i Kryetarit në bashkërendim me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun. Gjetjet mbi realizimin e planit do të shërbejnë si udhëzues për hartimin e planeve vjetore pasuese.

9. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kryetari i Komunës

Nxit, promovon dhe mbështetë kulturën e komunikimit të hapur dhe efikas brenda administratës komunale dhe kujdeset për një komunikim të shëndoshë me audiencat e jashtme. Mbështetë zbatimin efikas të kësaj Strategjie.

Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun në kabinetin e Kryetarit

Mbikëqyrë zbatimin e kësaj Strategjie. Është përgjegjës për vlerësimin periodik (vjetor) të zbatimit të kësaj strategjie.

Drejtorët e drejtorive komunale

Nxisin dhe mbikëqyrin zbatimin e kësaj strategjie brenda drejtorive të tyre dhe informojnë Kryetarin dhe Nënkryetarin e komunës për progresin në zbatimin e saj. Furnizojnë ZIMP me informacione të cilat meritojnë publicitet dhe vëmendje të publikut.

Koordinohen me ZIMP dhe me Kabinetin e Kryetarit për paraqitjet e tyre në media dhe publik.
Informojnë personelin e drejtorive me të cilat udhëheqin me zhvillimet që ndërlidhen me zhvillimet në komunë.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënieve me Publikun (ZIMP)

Është përgjegjëse për të mirëmbajtjen e faqes zyrtare të komunës në internet dhe llogarive në platformat sociale.
Është përgjegjëse për informimin e saktë dhe të kohshëm përmes kanaleve të komunikimit në dispozicion të komunës.
Kontribuon në pasurimin e formave të komunikimit dhe mbanë të informuar Kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e komunikimit të jashtëm.
Në bashkëpunim me kabinetin e kryetarit sigurohet për zbatimin e plotë të Planit të Transparencës.

Të punësuarit në administratën komunale

Kontribuojnë në format që zgjedhin ata për të përmirësuar praktikën e komunikimit në administratën komunale.
Bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive me eprorët e tyre në funksion të përmirësimit të komunikimit

Shtojca I: Plani vjetor për informim dhe komunikim 2023

PLANI VJETOR I VEPRIMIT PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2022

OBJEKTIVI I: AVANCIMI I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM NË ADMINISTRATËN KOMUNALE (AKTIVITETE TË VEÇANTA)			
AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA (€)
<i>Krijimi i listave të grupuara të kontakteve me audiencat për komunikim të brendshëm</i>	Shefi i kabinetit të kryetarit dhe ZIMP	2023	pa kosto shtesë
<i>Hartimi i Udhëzuesit për komunikim me email zyrtar me audiencat e brendshme dhe të jashtme</i>	Shefi i kabinetit të kryetarit ZIMP	2023	pa kosto shtesë
<i>Azhurnimi i Programit për Trajnime dhe ngritje profesionale</i>	Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e Personelit	2023	1000
<i>Takimi i Përgjithshëm (I) me stafin e administratës</i>	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e personelit	2023	100

Anketimi i personelit mbi efikasitetin e komunikimit (sipas pyetësorit të miratuar)	Shefi i kabinetit të kryetarit ZIMP Zyrtari i logjistikës	2023	pa kosto shtesë
Anketimi i personelit mbi kënaqshmërinë me kushtet në vendin e punës (sipas pyetësorit të miratuar)	Shefi i kabinetit të kryetarit ZIMP Zyrtari i logjistikës	2023	pa kosto shtesë
Takimi i Përgjithshëm (2) me stafin e administratës	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e personelit	2023	100
Konferenca Vjetore (gjithëditore) me pjesëmarrjen e zyrtarëve me përgjegjësi menaxhuese në komunë	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive	nëntor 2023	100 euro
Festa e fundvitit me personelin e administratës dhe mysafirëve të ftuar	Kryetari i komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive	Dhjetor 2023	500 euro

AKTIVITETE TË PËRSËRITURA :**AKTIVITETI****PËRGJEGJËSIA****SHPESHTËSIA**

Mbledhje te rregulta të udhëheqësve të sektorëve me personelin që kanë në mbikëqyrje.

Drejtorët e drejtorive

Në baza javore

Mbledhje e rregulta javore të Kryetarit me drejtorët e drejtorive.

Kryetari i Komunës
Shefi i Kabinetit

Në baza javore

Mbledhjet e rregulta mujore të Kryetarit apo Nënkryetarit me drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike

Kryetari i Komunës
Nënkryetari i Komunës
Drejtorët relevantë

Në baza tremujore

Raportet e konsoliduara periodike të administratës komunale

Kryetari komunës
Shefi i kabinetit të kryetarit

Në baza mujore

Përdorim i shtuar i intranetit qeveritar dhe aplikacioneve qeveritare për komunikim në

Drejtorët e drejtorive
Shefat e sektorëve
Zyra IT

Në vazhdimësi sipas rrethanave

distancë dhe punët ekipore (Skype for Business, Microsoft Teams)

Takime të përgjithshme me personelin e administratës komunale

Kryetari i komunës
Shefi i kabinetit të kryetarit
Nënkryetari i komunës
Njësia e personelit

Dy herë në vit

Informim i rregullt dhe i strukturuar i të punësuarve mbi ngjarjet dhe zhvillimet që ndërlidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës.

Kryetari komunës
Nënkryetari i komunës
Shefi i kabinetit të kryetarit
ZIMP

Sa herë që ka zhvillime që ia vlejnë të ndahen me të punësuarit (arritje, ngjarje, këshillime, etj.)

Takimet bashkërenduese të kryetarit me kryesuesin e kuvendit dhe KPF-në

Shefi i kabinetit të kryetarit
Njësia e Kuvendit të Komunës

Para secilës seancë dhe sipas nevojës

OBJEKTIVI 2: KRIJIMI I MEKANIZMAVE EFIKAS PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME MEDIAT (AKTIVITETE TË VEÇANTA)

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA
Trajnim mbi përdorimin efikas të platformave sociale (FB, Insatgram, Twitter, YouTube) për personelin në ZIMP	Njësia e personelit ZIMP	2023	500 €
Takim koordinues me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat – Tema: bashkëpunimi reciprok në transparencën e komunës dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje	Kryetari i Komunës ZIMP Kryetari i Kuvendit të Komunës	Mars- qershor 2023	200 €
Konferenca e Kryetarit të komunës për paraqitjen e Raportit Vjetor 2022	Kryetari i Komunës Drejtorët e drejtorive komunale	2023	pa kosto shtesë
Sondazh në webfaqe dhe Facebook mbi preferencat e tyre qytetarëve për projekte madhore publike.	ZIMP Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun	qershor-korrik 2023	pa kosto shtesë

"Dita e Dyerve të Hapura" të Komunës	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit ZIMP	korrik 2023	100 €
Tryezë e rrumbullakët tematike: "Perspektivat për zhvillimin e turizmit në komunën e Kaçanikut" dhe prezantimi i Hartave turistike të cilat planifikohen të krijohen nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik	Kryetari i Komunës Kryetari Kuvendit Drejtori për Zhvillim Ekonomik	Dhjetor	600 €
Pritje e fund vitit për përfaqësuesit e organizatave dhe donatorëve që mbështesin komunën	Kryetari i Komunës Drejtorët e drejtorive komunale	dhjetor 2023	500 €

AKTIVITETE TË PËRSËRITURA :**AKTIVITETI****PËRGJEGJËSIA****FREKUENCA**

Organizimi i konferencave për shtyp për çështjet dhe ngjarjet me rëndësi në Komunë

Kabineti i Kryetarit
ZIMP

Sipas rastit

Komunikata/njoftime për shtyp

Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun
ZIMP

Gjatë gjithë kohës

Intervista dhe prononcime

Kryetari i Komunës
Drejtorët e drejtorive
ZIMP
Personat e autorizuar

Gjatë gjithë kohës dhe sipas autorizimeve

Mirëmbajtja e webfaqes komunale dhe llogarive në platformat sociale

ZIMP
Zyrtarët për TI
Drejtoria

Gjatë gjithë kohës

Reklama/Shpallje

Kabineti i Kryetarit
Njësia e Personelit
Drejtorët e drejtorive

Sipas rastit dhe nevojës

	ZIMP	
Publikimi i dokumenteve në websajt në përputhje me dispozitat ligjore	ZIMP	Në vazhdimësi
Përdorim sistematik i mediave të reja dhe platformave sociale në funksion të informimit, komunikimit dhe promovimit të aktiviteteve të komunës.	ZIMP Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun	Në vazhdimësi
Monitorimi i rregullt i mediave	ZIMP Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun	Në vazhdimësi
Kontakte të rregullta me përfaqësuesit lokal në diasporë	Kryetari i Komunës Nënkryetari i Komunës Zyra IT	Në vazhdimësi
Transmetimi i seancave të Kuvendit të Komunës nëpërmjet websajtit dhe kanalit në YouTube	ZIMP Zyra IT	Në vazhdimësi

OBJEKTIVI 3: RITJIA E TRANSPARENCËS DHE PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE (AKTIVITETE TË VEÇANTA)			
AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA (€)
Krijimi i listave të kategorizuara të kontakteve me audiencat e jashtme	Shefi i kabinetit të kryetarit ZIMP Zyra IT	2022	Pa kosto shtesë
Ndërhyrjet në infrastrukturën e websajtit të komunës për organizimin dhe kategorizim më të mirë të informacioneve që i shërbejnë për publikun (raportet e ekzekutivit, financat e komunës, raportet e auditiveve, prokurimit, etj.)¹	ZIMP Zyra IT Drejtoritë komunale	2022	Pa kosto shtesë
Prezantim i Procedurave Standarde të Veprimit për publikimin e akteve dhe	ZIMP Zyra IT Drejtoritë komunale	2023	pa kosto shtesë

¹ Sipas rekomandimeve të MAPL, 2021

dokumente të komunës në uebsajtin e komunës			
Vlerësimi i zbatimit të Planit të Transparencës në vitin 2021	ZIMP Kabineti i Kryetarit	2023	pa kosto shtesë
Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me OJQ-të vendore për mbështetje në organizimin e takimeve dhe dëgjimeve publike të Komunës	Kryetari i Komunës Kryetari i Kuvendit të Komunës ZIMP	2023	100 €
Hartimi i Planit për dëgjimet, publike në lidhje me procesin e buxhetit komunal.²	ZIMP Kabineti i Kryetarit Kuvendi Drejtoritë komunale	2023	pa kosto shtesë
Organizimi i formave të reja të dëgjimeve publike në përputhje me Doracakun për Standardet Minimale për Organizimin e Konsultimeve Publike	Zyra për Informim Kryetari i Komunës Kryetari i Kuvendit të Komunës	2023	100€
Formimi i grupit profesional³ për analizën e performancës së komunës sipas raporteve të MAPL dhe organizatave vendore e ndërkombëtare	Nënkryetari i Komunës Koordinatori për performancë	2023	pa kosto shtesë
Përpilimi i listës së veprimeve për mënjanimin e mangësive të evidentuara nga raportet e performancës	Grupi profesional Koordinatori për performancë ZIMP	2023	pa kosto shtesë

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



² Dy dëgjime publike, Takim me Këshillat e Fshatrave, Debat me shoqatën e bizneseve, Tryezë e rrumbullakët me grupet dhe shoqatat profesionale, Diskutim i formatit Sallon me organizatat rinore, Diskutim panel me personat me aftësi të kufizuara, dëgjese publike me përfaqësueset e grave, etj.

³ Në përbërje të zyrtarëve të lartë të drejtorive përkatëse



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik
Municipal Kačanik
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	10.11.22	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.	Numri	Shtojcë	
	01	104/02-30297	/	

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

2023-2026

Zyra për Informim

1. Deklarata e transparencës

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një pikëpamje gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me transparencën, gjithë përfshirjen, kulturën organizative dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregullative.

Plani i Veprimit për transparencë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administrate komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarë dhe shoqërinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse. Përmes Planit, do të promovohet koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, në mënyrë që politikbërja të bazohet në argumente, fakte dhe të dhëna reale. Plani është dokument strategjik komunal, i hartuar në pajtim me orientimet e përcaktuara nga Strategjinë për Vetëqeverisje lokale dhe aktet juridike përcjellëse të nivelit qendror që promovojnë qeverisjen transparente.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që përtej informimit, synojnë mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes komunale. Për këtë arsye, zotohemi që Komuna e Kaçanikut me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin do të rris gatishmërinë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të qytetarëve për të qenë të angazhuar aktivisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave, për të siguruar që efektet e zbatimit të tyre të japin rezultatet e dëshiruara dhe afektojnë direkt interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Me plan të transparencës, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet, objektivat, metodat dhe mjetet efektive për rritjen e llogaridhënies, inkurajimin e qytetarëve për t'u bërë pjesë e qeverisjes, si dhe të ndikojmë tek punonjësit për të promovuar sjellje të mirë dhe të përgjegjshme.

Ne vlerësojmë se planifikimi i bazuar në informacion është metoda më e mirë e ndërtimit të qëndrueshëm të vizionit zhvillimor. Në funksion të kësaj, shërbimet cilësore komunale dhe administrimi i kërkesave të qytetarëve varet drejtpërdrejt nga mënyra e shpërndarjes së informatave, sistemet e aplikuara të informacionit, teknikat e konsultimit dhe veprime të tjera përcjellëse të organeve të administratës.

Prandaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e ndërlidhura me informim, por të bëjmë përpjekje për të siguruar praninë e vazhdueshme të qytetarëve dhe grupeve të interesit, me theks të veçantë organizatave të shoqërisë civile, duke përvijuar konceptin qytetarisë aktive dhe ndërtimit të qeverisjes së opinionit publik.

Besojmë që ky plan i veprimit për transparencë do të jetë një ndihmesë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, në krijimin e një ambienti më transparent të punës në administratë, rritjen e besimit të qytetarëve ndaj të zgjedhurve të tyre publik, gatishmërisë dhe përkushtimit më të madh, si dhe përpjekjeve për të fuqizuar e përmirësuar sistemin e menaxhimit brenda komunal.

Besim Ilazi
Kryetar i Komunës

Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Rruga drejt informimit publik efikas duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë, ndërkaq, komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është aspekti kyç që siguron vendimmarrje me bazë të gjerë. Fryma e institucioneve komunale duhet të adoptoj modelet më të avancuara të qeverisjes transparente brenda kornizës ligjore në fuqi.

Transparenca komunale është njëra nga segmentet e qeverisjes e cila monitorohet në vazhdimësi nga qeveria qendrore, por edhe nga akterë të tjerë ndërkombëtar, Komisioni Evropian, organizatat ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare. Marrë parasysh nivelin e përgjegjësi dhe shkallën e decentralizimit të pushtetit lokal në Kosovë, Kushtetuta dhe legjislacioni kanë paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore për të ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje në faza të caktuara të procesit të avancimit të transparencës dhe zhvillimit të politikave për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje lokale.

Komunat si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë të obliguara t'i krijojnë mekanizmat e përshtatshëm të informimit publik. Tani, struktura e ueb-faqeve zyrtare të komunave është unike. Përmes tyre është krijuar mundësia për qasje në të gjitha dokumentet me rëndësi publike. Përveç karakterit informues, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe linja me ndërfaqe të tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në Komunë, mundëson që qytetarët të parashirojnë online të gjitha kërkesat e tyre ndaj drejtorive përkatëse në komunë.

Fusha e transparencës komunale ka një strukturë të mirëorganizuar të rregullave juridike ligjore dhe nënligjore. Plani i Veprimit për Transparençë synon t'i grupoj përgjegjësitë kryesore të komunave



bazuar në këtë rregullativë juridike, për të shërbyer si dokument kornizë në një periudhë afatgjatë.

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Plani i veprimit për transparencë është hartuar nga Grupi Punues i caktuar nga Kryetari i Komunës me vendimin 01 Nr. 670/02-3370/2022 i datës 28.02.2022. Ky plan komunal ka për qëllim t'i ofrojë publikut qasje të lehtë në monitorimin dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Udhëzimi Administrativ Nr.2020/03 për Transparencë në Komuna përcakton obligimin që Komunitat të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan, kërkohet të përfshijë veprime që promovojnë: Mbledhjet e Kuvendit të Komunës; Komiteteve; Takimet publike; Takimet konsultative për projekte; Transparencën në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të Komunës; qasje të shpejtë në shërbime; Procedurat transparente të Prokurimit; Procedurat të punësimit; Përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare; Përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje etj.

Plani i Veprimit për Transparencë mundëson:

- Ndërlidhjen e planifikimit me sistemet e informacionit në mënyrë që supozimet e organeve të administratës gjatë zhvillimit të politikave të vërtetohen dhe legjitimohen;
- Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme;
- Rezultatet e punës së komunave të jenë të matshme, cilësore dhe në funksion të interesave të përgjithshme të qytetarëve.

Plani i veprimit për transparencë në mënyrë specifike do të kontribuojë që:

- Komuna të identifikoj me kohë prioritetet për të cilat kërkohet informimi, si dhe përfshirja e qytetareve apo grupeve të interesit;
- Të identifikoj metodat, mjetet dhe teknikat për konsultimin e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre;
- T'i evitoj praktikatat e zhvillimit të dokumenteve pa informacion të qartë dhe me kosto të papërbalueshme;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave;
- Mbajtjen e një sistemi koherent me të gjitha palët e interesit për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat dhe standardet ligjore;
- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet;

Zbatimi i Planit të Veprimit për Transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e Komunës. Plani do të përmbledh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, *rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e Kryetarit, njoftimet për aktivitetet e Kuvendit Komunal, takimet publike, transparencës buxhetore, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit publik, qasjen në dokumentet publike, etj.*

2. Transparenca si parim i qeverisjes së mirë

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerrjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet

vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenurit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta.

Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: qeverisje më e mirë, vendimmarrje më cilësore, besim më të madh publik, ulje të korrupsionit dhe shërbime publike më efektive. Transparenca përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarrjes, por edhe për nevoja të informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparenca nuk është vetëm informim, por përfshinë një varg procesesh dhe veprimesh të bazuara në: informacion, komunikim, pjesëmarrje, angazhim, ndërtim të konsensusit për zgjidhjen e problemeve, raportim dhe llogaridhënie.

Korniza ligjore për transparencë

Në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës janë miratuar një numër i madh i ligjeve dhe akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e transparencës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është aprovuar në vitin 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe bën pjesë në grupin e ligjeve me karakter vital për shtetin. Përmbajtja e këtij ligji reflekton parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke paraparë mekanizma të veçantë të informimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të drejtave të qytetarëve, e në veçanti të drejtave të komuniteteve jo shumicë. Me këtë ligj është përcaktuar që Kuvendi i Komunës të miratoj rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të Komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të Komunës. Përveç kësaj, me anë të një numri të konsiderueshëm të akteve nënligjore janë definuar edhe procedurat e zbatimit të instituteve të shumta juridike për transparencë, janë përcaktuar zyrtarët përgjegjës, format dhe teknikat për transparencë, si dhe afatet procedurale. Në përgjithësi, kuadri juridik normon obligime për organet e administratës shtetërore në fushën e transparencës, ndërsa në veçanti për organet e pushtetit, përmes akteve si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;

- Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
- Ligji Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë;
- Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

- Rregullore (QRK) Nr. 27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun;
- Rregullore Nr. 04./2012 për Evidencën Zyrtare të Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike;
- Rregullore (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik;
- Rregullore Nr. 02/2012/MF për Tarifatat në qasje në dokumente publike;
- Rregullore Nr. 01/2012 për Kodin e Etikës për Zyrtarët e Komunikimit me Publikun

- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2020 për Transparencën në Komuna;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2019 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informative “Teleprezenca”;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2018 për Funkcionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë;
- Udhëzim Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.03/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës;
- Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna;

Aktet komunale:

- Statuti i komunës;
- Rregullore komunale për transparencë;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me fushën e transparencës.

3. Qasja strategjike për fuqizimin e transparencës

Në nivel qendror janë zhvilluar një numër strategjish të cilat parashohin objektiva me synim reformën e administratës shtetërore. Ndër strategjitë kryesore në fushën e

qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në institucionet e administratës janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim, 2016-2021;
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia për Rregullim më të Mire 2017-2021;
- Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021;
- Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Agjenda për Reforma Evropiane;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA)
- Strategjitë e tjera sektoriale.

Dokument specifik me ndikim në transparencën komunale është Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji ka 5 objektiva kryesore përmes së cilave përcaktohen caqet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Në objektin e tretë të saj, strategjia parasheh *forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive*. Bazuar në problemet e identifikuar, në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihen aktivitetet konkrete të masave, që përfshijnë zhvillimin e politikave efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, respektivisht:

- Politikat lokale për nxitjen e aktivizimit qytetar;
- Politikat për nxitjen e punës vullnetare të studentëve dhe nxënësve;
- Politikat për funksionalizimin e qendrave rinore nëpër fshatra;
- Politikat për funksionalizimin e këshillave të fshatrave;
- Politikat për përfshirjen dhe angazhimin e pensionistëve në jetën publike;
- Politikat për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Politikat për nxitjen e pjesëmarrjes së grave si dhe kategorive sociale të pambrojtura;
- Politikat lokale për trajtimin e fëmijëve të rrugës;
- Politikat lokale për krijimin e rrjeteve sociale, ekonomike, rinore, sportive dhe kulturore.¹

Strategjia parasheh po ashtu masa konkrete në krijimin e platformave që fuqizojnë transparencën, e në veçanti përmes qeverisjes elektronike. Qeveria elektronike siguron që lehtëson komunikimin në mes të grupeve të interesit me autoritetet publike, derisa ajo forcon administratën përmes: kursimit të kohës në ofrimin e shërbimeve, uljes së kostos operative, rritjes së efikasitetit, ruajtjes së memories institucionale dhe rritjes së

¹ Qeveria e Republikës së Kosovës: "Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026", Prishtinë, 2016, fq. 32

llogaridhënies. Edhe strategji të tjera në nivel vendi ofrojnë qasje shumëdimensionale për ndërhyrje në politikat e transparencës. Një numër objektivash që synojnë krijimin e sistemit gjithëpërfshirës dhe të menduar mirë në përgatitjen e politikave, janë paraparë në Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2017-2021. Rekomandimet kryesore të dhëna nga kjo strategji theksojnë nevojën për:

- Hartimin e rregulloreve të bazuara në dëshmi, analiza dhe konsultime;
- Përmirësimin e mëtejshëm të komunikimit gjatë procesit të zhvillimit të politikave dhe gjatë fazës së zbatimit të tyre;
- Miratimin e rregulloreve dhe politikave nga qeveria, ashtu që komunikimi efektiv të sigurojë që grupet e synuara dhe palët e interesit njoftohen për të drejtat e tyre, mundësitë dhe detyrimet;
- Krijimin e një planifikimi të komunikimit përmes zhvillimit të planeve të komunikimit për prioritetet e politikave, pasi që mbetet një sfidë e vazhdueshme;
- Krijimi i platformës *online* për konsultimet publike (objektiv i veçantë), si dhe
- Jetësimin e rregullave standarde të konsultimit publik.

Krahas kësaj, Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë 2017-2021, shtron nevojën për:

- Ndërlidhjen e dokumenteve sektoriale strategjike me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim;
- Ndërlidhjen e politikave me Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së;
- Zbatimin e strategjive sektoriale;
- Përmirësimin e koordinimit gjatë hartimit të politikave me të gjithë akterët.
- Rregullimin e afateve kohore gjatë konsultimeve ndërministrore dhe publike, për shkak se shpesh ato janë të shkurtra dhe nuk lejojnë ofrimin e një kontributi efektiv nga shoqëria civile.
- Intervenimet në reformat e planifikuara duke përfshirë konsultimin me palët e brendshme dhe të jashtme të interesit.

Andaj, masat e tilla të ndërhyrjes janë të rëndësishme, për faktin se përmirësojnë komunikimin me qytetarë, krijojnë hapësirë për politikbërje të qëndrueshme, zbatim efikas të tyre, si dhe plotësojnë obligimet e Kosovës në raport me kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian.

4. Mekanizmat ligjor për pjesëmarrje dhe zbatim të parimit të transparencës

Qeverisja lokale në Kosovë promovon fuqishëm parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë në të cilën transparenca mund të ndihmojë në ofrimin e paanësisë është duke lejuar publikun të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin që rregullat të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Qytetarët nuk mund të jenë askund më afër me shtetin se përmes organeve të pushtetit lokal. Komunat janë adresa më e afërt për të kërkuar që shërbimet dhe resurset shpërndahen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në pajtim me nevojat sistematike të tyre.

Numri më i madh i taksave dhe tatimeve që mbledhen nga shteti, u shpërndahen komunave për ushtrimin e kompetencave ligjore. Taksat për të cilat qytetarët paguajnë në baza periodike janë burime vetanake të komunave, të cilat shpenzohen për shërbimet e ofruara. Planifikimi i shpenzimit të tyre bëhet me anë të buxhetit komunal, që është dokument kryesor vjetor që mbledh të gjitha projektet investive me interes publik. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komunat ligjërisht obligohen të mbajnë konsultime me qytetarët, bizneset, grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Prandaj, qeverisja e mirë komunale do të zinte vend vetëm nëse planifikimi i mjeteve buxhetore, politikave të tjera, shpenzimet e tyre dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve publike do të mbështetej në opinionin e qytetarëve, përmes formave të shumta të përfshirjes direkte të tyre.

Në mënyrë që transparenca të jetë pjesë përbërëse e politikbërjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë:

- Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë;
- Konsultimet për projekte dhe dokumente të politikave;
- Informimi dhe konsultimi përmes e-qeverisjes;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- E drejta për qasje në dokumentet publike.
- Komitetet konsultative;
- Iniciativat qytetare, petitionet dhe referendumat lokale;

Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikatat e shumta të dala nga raportet e monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkaqe juridike, por edhe praktike.

5. Objektivat e Planit të Veprimit për transparencë

Objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është *“të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente dhe llogaridhënëse”*.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale.
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë direkte, për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit në mënyrë që qytetarët të dëgohen dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendimmarrëse.
- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i draftimit të politikave është baza e informacionit.
- Ndërtimi i partneritetit të mirëfilltë me shoqërinë civile, në të gjitha fazat e menaxhimit të organeve komunale.

Fazat e zhvillimit të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale

Zhvillimi i Model – Planit të veprimit për transparencë përbëhet prej disa faza si në vijim:

- 1) **Faza Paraprake** – Kryetari i komunës themelon grupin e punues. Përbërja e grupit punues duhet të jetë shumësektoriale dhe të udhëhiqet nga Zyra për Komunikim Publik në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës. Procedurat e hartimit zhvillohen në pajtim me rregullat në fuqi për procedurat e hartimit të akteve komunale.
- 2) **Faza e vlerësimit të prioritetëve** – gjatë kësaj faze, kryesuesi së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionet e mbledhura (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së Komunës; dokumentet strategjike të Komunës mbi bazën e të cilave priten të zhvillohen aktet juridike të Komunës, planet komunale, dokumentet e tjera të politikave për të cilat duhet të zhvillohen konsultime publike dhe të sigurohet prania e qytetarëve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe planeve afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjate,

duhet të përcaktohen prioritetet dhe të bëhet renditja e veprimeve për secilin aktivitet.

- 3) **Faza e përcaktimit të aktiviteteve dhe propozimit të masave** – kjo fazë përfshin kategorizimin e prioritetëve sipas periudhave të zhvillimit, renditjen e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të veprimit, afatet kohore, organet/zyrtarët përgjegjës, koston financiare.
- 4) **Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë** - përfshin monitorimin, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të Veprimit për Transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës Kryesuesi i grupit punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.

Metodologjia e vlerësimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të transparencës

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioritetëve, duke mundësuar që Komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçe të menaxhimit: 1) Planifikim; 2) Zbatim; 3) Raportim.

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: Natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerret nga organi përkatës i komunës; Llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve; Fushëveprimit të akteve juridike të planifikuara për hartim; Ndikimit të tyre ekonomik dhe social; Peshës financiare të politikës së propozuar; Periudhës kohore të veprimit; Shtrirjes gjeografike; etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve grupi punues cakton prioritetet dhe metodat e veprimit të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e planit të veprimit, të cilat janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

6. Monitorimit i zbatimit të Planit të transparencës

Zbatimi i Planit të veprimit për transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politikbërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendimmarrës.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendimmarrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të planit të veprimit për transparencë, krijohet mekanizmi për monitorimin dhe raportimin për këtë plani, si në vijim:

Grupi punues - emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh sigures i zbatimit të planit dhe garanton që në baza periodike Plani Vjetor i Punës së Komunës të ndërlihet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.
- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Monitoron zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek Kryetari për zbatimin e planit të veprimit për transparencë;

Me hyrjen në fuqi të këtij plani, shfuqizohet Plani i Veprimit me numër 01.Nr.40 i datës 29.03.2019



7. Plani i Veprimit

Nr. Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës.
1 Mbledhje të hapura të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve	Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve në: Web fagen zyrtare Në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës Rrjete sociale	Sekretaria e Kuvendit përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjeve për mbledhjet e kuvendit dhe tri ditë për mbledhjet e komiteteve	Shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjeve për mbledhjet e kuvendit dhe tri ditë për mbledhjet e komiteteve
2 Përgatitja dhe publikimi i informatave nga mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve	Përgatitja e informatave pas çdo mbledhje të Kuvendit dhe komiteteve për mediat e shkruara dhe elektronike si dhe rrjetet sociale	Zyra për Informim	
3 Takimet e kryetarit me publikun	Kryetari i Komunës së Kaçanikut mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm	Zyra e Kryetarit, përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në web fagen zyrtare, rrjete sociale dhe	Salla e kuvendit Njoftimi 2 javë para mbajtjes

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr. Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunës.
		në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës		
4 Konsultimet me publikun	Komuna e Kaçanikut organizon konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal	Sekretaria Kryetarit, përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në web faqen zyrtare, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës dhe rrjetet sociale	Kuvendi komunal	Njoftimi 2 javë para mbajtjes
5 1. Raportet/Informatat për media të Kryetarit dhe drejtorive Komunale	Kryetari i Komunës së Kaçanikut dhe drejtorët e Drejtorive komunale publikon raportet/informatat, të paktën dy herë brenda vitit.	Zyra për Informim Publik publikon raportet/informatat në web faqen zyrtare dhe faqen zyrtare të Komunës në rrjetin social Facebook.		

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr. Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunës.
6 Raportet/Informatat për media të Kryesuesit	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut publikon raportin/informatën të paktën dy herë brenda vitit	Zyra e Kuvendit përgatit raportin/informatën dhe i përcjell zyrës së informimit për publikim në web faqen zyrtare dhe faqen zyrtare të komunës në rrjetin social Facebook		
7 Takimet e Kryetarit me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë	Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në kuadër të kompetencave të tij, realizon takime në formë debati me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë	Debatet e tilla i organizon Kabineti i Kryetarit, duke siguruar hapësirë të mjaftueshme për pjesëmarrje.	Zyra e Kryetarit ose salla tjera alternative	
8 E drejta e qasjes në dokumente publike	Për të qenë sa më transparent ndaj publikut, Komuna e Kaçanikut, bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, të aprovuara nga organet e Komunës dhe i adreson ato në pajtueshmëri me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet publike		7 ditë
9 Kërkesat për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet	Subjekti fizik ose juridik ka të drejtë të parashtojë kërkesë në Komunën e Kaçanikut, për realizimin e iniciativave qytetare	Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari, Drejtorja, Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë, jo më		

PLAN I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr. Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunës.
	dhe peticioneve për çështje që janë në përgjegjësi të organeve komunale.	vonë se 15 ditë nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.		
10 Publikimi i akteve komunale	Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit Komunal të Kaçanikut publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun	Sekretaria e Kuvendit përmes Zyrës për Informim Publik dhe njësisë e IT-së, publikon aktet komunale në web faqen zyrtare		
11 Publikimi i të gjitha raporteve, vendimeve, rregulloreve, buxhetit komunal, projekteve kapitale, projekteve të planifikuara, tenderëve, etj. të zyrës së kryetarit, dhe shërbimeve tjera të komunës	Të gjitha raportet, vendimet, buxheti komunal, projektet kapitale, projektet e planifikuara, tenderët etj, nga zyra e kryetarit dhe shërbimet e tjera të komunës do të bëhen publike dhe të qasshme për qytetarët	Kabineti i Kryetarit përmes Zyrës për Informim Publik dhe Njësia e IT-së publikon aktet komunale në web faqen zyrtare		
12 Mirëmbajtja dhe freskimi i web faqes zyrtare	Web faqja zyrtare e Komunës së Kaçanikut freskohet me lajme e informacione nga aktivitetet e	Përgjegjëse për këtë është Zyra për Informim e Komunës së Kaçanikut.		

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës.
	përdishme të ekzekutivit dhe vendimmartjes, si dhe materiale tjera publike sipas udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020				
13	Transmetimi i seancave të kuvendit komunal	Transmetimi i seancës së kuvendit komunal përmes video injizimit, i cili më pas transmetohet në faqen zyrtare të Komunës si dhe në rrjetin social Komuna e Kaçanikut ka të hapur faqen zyrtare në rrjetin social Facebook, ku publikohen të gjitha informatat e ekzekutivit dhe vendimmartësve sikurse edhe dokumente të tjera.	Përgjegjëse për këtë është Njësia e IT-së e Komunës së Kaçanikut.		
14	Shfrytëzimi i rrjeteve sociale		Përgjegjëse për këtë fage është Zyra për Informim Publik dhe njësia e IT-së		
16	Qasje e lehtë e qytetarëve në shërbimet digjitale	Komuna e Kaçanikut ka mundësuar aplikimin online për certifikatat e gjendjes civile, në web faqen zyrtare të Komunës. Poashtu për të lehtësuar proceduarat janë publikuar edhe disa udhëzues për dokumente të	Përgjegjëse është Drejtoria e Administratës përmes Zyrës për Informim Publik dhe Njësia e IT-së		

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Për Objektet e planit të veprimit		Aktivitetet e planit të transparentës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës.
		ndryshme të gjendjes civile, kadasitri etj.			
17	Prokurimi transparent	Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Departamenti i Prokurimit i dërgon me kohë të gjitha njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënie të kontratave, njoftimet për konkurse të projektimit dhe njoftimet për vazhdim të afatit.	Përgjegjës për publikim të tyre në web faqe është Departamenti i Prokurimit, Zyra për Informim njësia e IT-së e komunës.		Sipas afateve ligjore
18	Transparenca në procedurat e punësimit	Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Zyra e Personelit është përgjegjëse për publikim në web faqe të konkurseve, njoftimeve për përzgjedhjen e kandidatëve, njoftimeve për anulim të konkurseve, rishpalljen apo vazhdimin e afateve, avancimet brenda institucionit si dhe aplikacionet për punësim.	Zyra e Personelit në bashkëpunim me Zyrën për Informim Publik dhe njësia e IT-së		Sipas afateve ligjore

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Kryetari

Besim Iliu





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kacanik

01-Nr. 60/01-30764/22
Kaçanik; 16.11.2022

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit nr.(Nr.08/L-066) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, të nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR TRANSFERIN E MJETEVE BUXHETORE

Transferet e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10):

Nga nën-programi:

Shërbimet sociale-Kaçanik-75636 Kodi funksional 1040, nga projekti me kod 51214 “Ndertimi dhe funksionalizimi i objekteve për banim social” shuma prej 29,900.00€

Transferohen në kategorinë e Shpenzimeve kapitale (fondi 10):

Në nën programet:

-Planifikimi urban dhe inspeksioni-66445, Kodi funksional 0620 në projektin me kod 50201 “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale-Kaçanik” shuma prej 20,000.00€ dhe në Nën-programin Administrata-16328, Kodi funksional 0133 në projektin me kod 86246 “Furnizimi me mobilje dhe pajime”, shuma prej 9,900.00€.

Transferet e mjeteve nga kategoria e shpenzimeve komunale (fondi 10):

Nga nën-programi:

Shërbimet e shëndetësisë primare-74700 Kodi funksional 0721, shuma prej 11,000.00€;

Transferohen në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve (fondi 10):

Në nën programin:

Shërbimet e shëndetësisë primare-74700 Kodi funksional 0721, shuma prej 11,000.00€.

3.Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfere
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Department

KËRKESA PËR TRANSFER /RIALOKIM

PJESA 1: TË DHËNAT E TRANSFERIT / RIALOKIMIT													
Emri i organizatës buxhetore		Komuna e Kaçanikut						Kodi	652				
Emri i nën-programit		Sherbimet e shëndetësisë primare						Kodi	74700				
Transferi/Rialokimi													
Kodi organizativ	Kodi i nën-programit	Kodi funksional	Burimet e financimit	Projekti	Kodi i projektit	Kategori ekonomike	Aprovimi i tanishëm	Shuma e ndryshimit	Aprovimi i ri	Buxheti Aprovuar/Rishikuar	Totali i shumës së transferuar/rialkuar	% Transferi/Rialokimi (i ri ndaj buxhetit)	
652	74700	0721	10/21			14	75,000	(11,000)	64,000	75,000	(11,000)	(14.67)	
652	74700	0721	10/21			13	140,284	11,000	151,284	140,284	11,000	-	
							215,284	-	215,284	215,284	-	-	
PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË TRANSFERUAR /RIALOKUARA													
(Shëno Po ose Jo)						Transferi / rialokimi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve			PO	JO			
									PO				
						Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rrjedhës së pasqyrës			PO				
PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)													
Transferi i mjeteve bëhet përshkak të paraqitjes së mungesës së mjeteve në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime nënprogrami Sherbimet primare shëndetësore për furnizim me artikuj shëndetësorë, mungesa e mjeteve ka ndodhur për shkak të ngritjes së çmimeve për furnizim me pelet, derivate, shërbimet e sigurimit fizik, etj ku çmimi për njësi të këtyre kontratave të arritura ka tejkaluar dukshëm çmimet e kontratave paraprake. Në anën tjetër bazuar në raportet e sistemit FREE-BALANCE, paraqiten tepërca të mëdha të mjeteve të kategorisë e shpenzimeve komunale, mirepo ne kërkojmë transferin e vetëm përqindjes së lejuar deri në 15% të nënprogramit për këtë kategori ekonomike, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e mjeteve do të regjistrohet shtesë në Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2022.													
ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ËSHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PËRFAQËSON PËRDORIM EFTËNTIV DHE EFTKAS.													
TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS													
Zyrtari kryesor financiar						Data	Zyrtari Kryesor Financiar/Kryeshafi Ekzekutiv			Data			
Gafurr Loku						15.11.2022	Besim Jazi			15.11.2022			
PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI													
ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)													
KËRKO NDYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE								NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA*					
Drejtor i Buxhetit								Data	Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave*			Data	
Salvador Elmazi													
								NUMRAT E KD					

Vrejtje:

*Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategori ekonomike të nën-programit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfere
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Buxhetit-Budzet Department-Budget Department

KËRKESA PËR TRANSFER /RIALOKIM

PJESA 1: TË DHËNAT E TRANSFERIT / RIALOKIMIT

PJESA 1: TË DHENAT E TRANSFERIT / RIALOKIMIT												
Emri i organizatës buxhetore			Komuna e Kaçanikut						Kodi	652		
Emri i nën-programit			Sherbimet sociale, Planifikimi Urban dhe inspeksioni, Administrata e Përgjithshme						Kodi	75636, 66445, 16328		
Transferi/Rialokimi												
Kodi organizativ	Kodi i nën-programit	Kodi Funkcional	Burimet e Financimit	Projektet	Kodi i projektit	Kategoria ekonomike	Aprovimi i tanishëm	Shuma e ndryshimit	Aprovimi i ri	Buxheti Aprovuar/Rishikuar	Totali i shumës së transferuar/rialokuar	% Transferit/ Rialokimit (i ri ndaj buxhetit)
652	75636	1040	10	Ndërtimi dhe funksionalizimi i objekteve për banim social	51214	30	200,000.00	(29,900.00)	170,100.00	200,000.00	(29,900.00)	
652	66445	0620	10	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale-Kaçanik	50201	30	210,000.00	20,000.00	230,000.00	180,000.00	20,000.00	
652	16328	0133	10	Furnizim me mobilje dhe pajime	86246	30	-	9,900.00	9,900.00	-	9,900.00	
							410,000	-	410,000	380,000	-	
652	75636	1040	10	Totali i nën-programit		30	200,000	(29,900)	170,100	200,000	(29,900)	(14.95)

PJESA 2: ALOKIMI I NDARJES BUXHETORE TË TRANSFERUAR /RIALOKUARA

(Shëno Po ose Jo)	Transferi / rialokimi të pasqyrohet në ndryshimet e alokimeve	PO	JO
	Konfirmo që është dhënë plani i rishikuar i rrjedhës së parës?	PO	

PJESA 3: ARSYETIMI (Të plotësohet nga organizata buxhetore)

Per projektin me kod 51214 "Ndërtimi dhe funksionalizimi i objekteve për banim social", me datë 19.10.2022 pas shumë vonesave është arritur kontrata për periudhë dyvjeçare, e cila ka vlerën prej 406,747.20 euro. Ndarjet buxhetore të miratuara për këtë projekt janë në shumë prej 200,000.00 euro në vitin aktual 2022 dhe shuma prej 250,000.00 euro në vitin 2023, total planifikimi 450,000.00 euro, diferenca apo kursimi mes planifikimit dhe vlerës së konstatuar është 43,252.80 euro. Përshkak të aritjes së kontratës me vonesë dhe kur kemi edhe shumë pak kohë deri në përfundimin e këtij viti fiskal, vlerësojmë se Operatori Ekonomik i përzgjedhur nuk do të arrijë të realizojë punimet sipas vlerës së planifikuar për shpenzim të këtij viti, prandaj kemi kërkuar që nga vlera totale e kursimit prej 43,252.80 vetëm shumën prej 29,900.00€ (200,000.00€ x 14.90%) konform Ligjit në fuqi Nr.03/L-048, të transferojmë shumën e tepërisë së mjeteve në projektet të cilat kemi mundësi të mjeteve buxhetore.

ORGANIZATA BUXHETORE CERTIFIKON QË KËRKESA ËSHTË KONSISTENTE ME LIGJIN E BUXHETIT DHE PËRFAQËSON PËRDORIM E FEFKIV DHE EFKAS TË FONDEVE, KONSISTENT ME OBJEKTIVAT BUXHETORE TË ORGANIZATËS

Zyrtari kryesor financiar	Data	Zyrtari Kryesor Financiar/Kryeshefi Ekzekutiv	Data
Gafurr Loku	26.10.2022	Besim Ilazi	26.10.2022

PJESA 4: ANALIZA DHE APROVIMI

ANALIZA E MF (Të plotësohet nga analisti i buxhetit)			
KËRKË NDRYSHIMET NË NDARJE BUXHETORE		NDARJA BUXHETORE KD E REGJISTRUAR NË SIMFK NGA*	
Drejtor i Buxhetit	Data	Departamenti i buxhetit regjistrimi i të dhënave*	Data
Salvador Elmazi			
		NUMRAT E KD	

Vrejtje:

*Kolona e hijezuar paraqet totalin e ndarjes buxhetore për kategori ekonomike të nën-programit



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01-30793/21
Kaçanik, 16.11.2022

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 (c) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës 01Nr. 6/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të nenit 15.1(c) lidhur me nenin 55 të Rregullores 01Nr. 7864/08 për Punë të Kuvendit të Komunës të datës 13.11.2008, Kryesuesi i Kuvendit bënë këtë:

PROPOZIM

Që Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me _____ të merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, në përbërje prej 5 anëtarëve, 4 anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, si vijon:

1.1.	Kemal Murseli,	kryesues	nga KK
1.2.	_____	anëtar	nga KK,
1.3.	_____	anëtar	nga KK
1.4.	_____	anëtar	nga KK
1.5.	Makfire Malsiu	anëtar	nga Zyra e Kryetarit

2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi do të hartoj Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 dhe për të njëjtin do t'i zhvilloj procedurat e nevojshme sipas rregullave ligjore në fuqi deri me miratimin e planit nga Kuvendi i Komunës.

3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli